EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5729
E martë, 19 mars 2019
çmimi 0.40 €

Limaj merr pjesë në shënimin e 104-vjetorit të betejës së Çanakalasë

FAQE2

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", FATMIR MATOSHI FAQE 4-5

Taksa duhet të shqyrtohet

- Taksa në raport me Serbinë është e merituar, por në raport me kërkesën e miqve tanë duhet të shqyrtohet

Anëtari i Kryesisë së Aleancës Kosova e Re (AKR), njëherësh ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka thënë se taksa është vendim meritor për Serbinë dhe Bosnje e Hercegovinën, por në raport me kërkesën e miqve duhet të shqyrtohet.

Ai ka theksuar se AKR-ja nuk pret që taksa t'i dëmtojë raportet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA-në) dhe Bashkimin Evropian (BE-në). Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Matoshi ka deklaruar se secili subjekt politik para prishjes së raporteve me ShBA-në do të duhej ta zgjedhte largimin nga qeveria. Duke folur për funksionimin e koalicionit qeverisës, Matoshi ka thënë se deri më tani qeveria ka kryer punë të mira dhe, sipas tij, AKR-ja ka arsyetuar besimin e marrë në këtë qeveri

PUNËSIMET POLITIKE PO E SHKATËRROJNË KOSOVËN

Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O'Connell, ka kritikuar institucionet e Kosovës për punësime politike. Ai ka thënë të hënën se nepotizmi dhe punësimet politike po i shkatërrojnë institucionet. Edhe kryeparlamentari Kadri Veseli ka kritikuar abuzimin e njerëzve të pushtetshëm për emërimet politike në pozita të institucioneve të pavarura.

Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka pranuar se ende ka lëshime në këtë drejtim FAQE 3

Kurti: Zgjedhjet e reja janë aq shumë të nevojshme

AKTUALE

SERBËT E KOSOVËS DUHET T'I THONË JO VUÇIQIT!? F. 11

Halil MATOSHI

PAJISJET E REJA LEHTËSOJNË PUNËN NË KLINIKËN E GJINEKOLOGJISË F. 6

KOSOVA VLERËSON KONTRIBUTIN E SHBA-së PËR FORCIMIN E MEKANIZMAVE TË SIGURISË F. 5

EKONOMI

LANSOHET APLIKACIONI MOBIL PËR PREZANTIMIN E TË DHËNAVE MBI CILËSINË E AJRIT F. 9

VERËRAT E KOSOVËS PROMOVOHEN NË PANAIRIN 'PROWEIN 2019' NË GJERMANI F. 8

KULTURË

HAPET EKSPOZITA 'ZANI I SHPIRTIT' NGA DËBORA HETEMI F. 6



SPORT

CHALLANDESI 'HARRON' SUKSESIN NË LIGËN E KOMBEVE: GJITHÇKA FILLON NGA ZERO F. 18

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kosova vlerëson kontributin e ShBA-së për forcimin e mekanizmave të sigurisë

Kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur të hënën në takim ndihmëssekretaren për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL) të ShBA-së, Kirsten Madison, e cila është duke qëndruar për një vizitë zyrtare në Kosovë. Haradinaj ka thënë se me mbështetjen e parezervë të ShBA-së, vendi ynë ka arritur progres substancial për konsolidimin e mekanizmave të sigurisë

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 MARS - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të hënën në takim ndihmëssekretaren për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL) të ShBA-së, Kirsten Madison, e cila është duke qëndruar për një vizitë zyrtare në Kosovë. Kryeministri Haradinaj e ka njoftuar ndihmëssekretaren Madison për të arriturat e Qeverisë, për zhvillimin ekonomik të vendit, për prioritetet për forcimin e sundimit të rendit dhe të ligjit, për luftën kundër korrupsionit, narkotikëve dhe delikuencës, për riatdhesimin dhe për tema të tjera me rëndësi për vendin. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka falënderuar ndihmëssekretaren Madison dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës për ndihmën dhënë Kosovës në të gjitha periudhat, duke vlerësuar se ndihma e pakursyer e ShBA-së është e nevojshme edhe në këtë periudhë të shtetndërtimit dhe forcimit të subjektivitetit ndërkombëtar të saj.

Kryeministri Haradinaj ka falënderuar ndihmësekretaren Madison për kontributin e ShBA-së për forcimin e mekanizmave të sigurisë në vend, veçmas në asistencën për policinë, gjykatat dhe Prokurorinë, ndihmë kjo që ka rezultuar me ngritjen e kapaciteteve të vendit në këto institucione. "Falë ndihmës suaj, të dhënë në vazhdimësi, ne sot kemi institucione kredibile dhe të cilat kanë shënuar suksese në vend, por edhe në partneritet me institucionet e huaja", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shprehur përkushtimin e Qeverisë së vendit për përparimin e vazhdueshëm në fushën e sundimit të rendit, ligjit dhe sigurisë.

Ndihmëssekretarja e Shtetit për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimin e Ligjit (INL), Kirsten D. Madison, gjatë qëndrimit në Kosovë ka realizuar edhe një vizitë zyrtare në Policinë e Kosovës, ku është pritur nga drejtori i Departamentit për Hetime në këtë institucion, Riza Shillova, i cili në emër të Policisë së Kosovës e ka falënderuar ndihmëssekretaren Madison për vizitën si dhe për përkrahjen e vazhdueshme që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë ofruar për Policinë e Kosovës në fusha të ndryshme. "Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave, trajnimet dhe pajisjet e ndryshme teknike dhe teknologjike të ofruara nga ShBA-ja përmes INL-it dhe ICITAP-it, kanë ndikuar për ngritjen profesionale dhe të kapaciteteve të PK-së, për arritjen e rezultateve pozitive në fusha të ndryshme të IT-së, krimeve kibernetike etj., në veçanti në fushën e parandalimit dhe konfiskimit të narkotikëve. PK-ja në vazhdimësi ka treguar rezultate pozitive në fushën e parandalimit të trafikimit të narkotikëve, përderisa në vitin 2018 ka treguar rezultate më të theksuara në arrestim, parandalim dhe konfiskim të substancave të ndryshme narkotike, e në veçanti në konfiskimin e 119 kg heroinë", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Sipas këtij njoftimi, ndihmëssekretarja amerikane Kirsten D. Madison ka përgëzuar drejtorin e Hetimeve në Policinë e Kosovës, Riza Shillova, për sukseset e treguara kohët e fundit në luftën kundër narkotikëve.

Limaj merr pjesë në shënimin e 104-vjetorit të betejës së Çanakalasë

PRISHTINË, 18 MARS - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka marrë pjesë në shënimin e 104-vjetorit të betejës së Çanakalasë.

Në shënimin e kësaj beteje të hënën në stadiumin e qytetit të Çanakalasë është organizuar një ceremoni, ku i pranishëm ishte edhe presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, e i ftuar ka qenë edhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj. Pas përfundimit të ceremonisë në stadium ka vazhduar pjesa e dytë e ceremonisë në Memorialin e Dëshmoreve të Çanakalasë.

Në 104-vjetorin e kësaj beteje janë vlerësuar lart të gjithë të rënët nga vendet mike që luftuan përkrah Turqisë, duke veçuar edhe pjesëmarrësit në këtë betejë nga trojet shqiptare. Pjesë e kësaj ceremonie ishin krerët më të lartë të shtetit turk dhe personalitete të tjera të rëndësishme evropiane.

Meta: Politika të marrë përgjegjësi për krizën, të mos fshihet pas ndërkombëtarëve

TIRANË, 18 MARS - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka kërkuar nga klasa politike, mazhoranca dhe opozita, të mos humbasin më kohë për ta zgjidhur krizën ku është futur vendi. Në një prononcim për mediet, presidenti shprehu keqardhjen që përfaqësuesit politikë, deri më tani, me veprimet dhe reagimet e tyre kanë thelluar përkeqësimin e situatës. Duke bërë apel për ta parë interesin e vendit dhe integrimin në Bashkimin Evropian, presidenti kërkoi nga të gjitha palët përgjegjshmëri.

I pyetur për rolin e ndërkombëtarëve, Meta deklaroi se tani është koha që klasa politike shqiptare t'i marrë përgjegjësitë e duhura dhe të mos fshihet pas deklaratave të ndonjë ndërkombëtari. I pyetur për rolin e ndërkombëtarëve, ai deklaroi se tani është koha që klasa politike shqiptare t'i marrë përgjegjësitë e duhura dhe të mos fshihet pas deklaratave të ndonjë ndërkombëtari.

Presidenti Meta u shpreh se shkaqet e krizës në vend janë të brendshme dhe kërkoi reflektim nga gjithë klasa politike. Presidenti ka komentuar edhe deklaratat që vijnë nga zyrtarët e lartë të mazhorancës, që lidhin krizën politike me ndikimin e Rusisë në Shqipëri. "Ne jemi të ndërgjegjshëm për ndikimet shpesh toksike, për fat të keq, në rajonin tonë, por nuk besoj se ky është një problem në rastin e Shqipërisë.

Ne do të donim që Rusia ta respektojë zgjedhjen e gjithë popujve të rajonit për t'u integruar në BE dhe NATO, por është e drejta e saj të reagojë ndryshe. Nuk duhet ta katandisim rrezikun rus si rrezikun anglo-amerikan në periudhën e së kaluarës, për t'i fshehur shkaqet e vërteta të kësaj krize kushtetuese, politike, morale, të cilat janë të krijuara nga ne dhe kërkojnë reflektim nga të gjithë", tha Ilir Meta.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Shënohet trevjetori i memorandumit të mirëkuptimit për rekrutimin e pozitave të larta drejtuese në mes të Ambasadës së Britanisë dhe institucioneve të Kosovës

Punësimet politike po e shkatërrojnë Kosovën

Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O'Connell, ka kritikuar institucionet e Kosovës për punësime politike. Ai ka thënë të hënën se nepotizmi dhe punësimet politike po i shkatërrojnë institucionet. Edhe kryeparlamentari Kadri Veseli ka kritikuar abuzimin e njerëzve të pushtetshëm për emërimet politike në pozita të institucioneve të pavarura. Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka pranuar se ende ka lëshime në këtë drejtim

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 18 MARS - Ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O'Connell, ka bërë me dije se punësimet politike po e shkatërrojnë Kosovën. Gjatë konferencës së projektit të Ambasadës së Britanisë për rekrutimin e pozitave të larta drejtuese në shërbimin civil dhe institucionet e pavarura, diplomati britanik ka deklaruar se ky projekt ka kthim prapa, ngase ndikimet në punësime vazhdojnë të jenë të mëdha. Sipas tij, korrupsioni dhe nepotizmi janë dy problemet më serioze me të cilat po përballet Kosova. "Suksesi i këtij projekti është sukses i Kosovës, por edhe dështimi i tij është i Kosovës. As ne si ambasadë e as partnerët nuk marrim vendime. Vendimet merren nga zyrtarët e Kosovës. Për fat të keq, edhe sivjet kemi emërim të pozitave të pakualifikuara. Agjencia kosovare për Verifikim të Pronave është shembull i tillë", ka thënë O'Connell. Sipas tij, punësimet politike në këtë vit kanë qenë më të theksuara. "Vitin e kaluar në konferencën e tillë pata thënë se projekti po shkon më mirë se që kisha pritur. Për fat të keq, sivjet nuk mund të konfirmoj të njëjtën gjë. Në fakt, kemi kthim mbrapa", ka thënë ai.

Ambasadori britanik ka vlerësuar se ky projekt ka sjellë një metodologji të re, por varet nga politikat nëse kjo metodologji do të përdoret në mënyrë të drejtë. "Ambasada i Britanisë merr shpesh ankesa nga persona që marrin mundin të aplikojnë për pozita të ndryshme dhe që janë vlerësuar mirë nga projekti, por të cilët nuk arrijnë të emërohen", është shprehur ai, duke shtuar se ata që nuk arrijnë të emërohen nuk kanë lidhje politike dhe kjo duhet të jetë e rëndë. "Rasti konkret është Enis Berisha ,i cili deri më tani është vlerësuar mirë në shtatë procese, madje në disa vende vlerësohet si kandidat me shumë pikë, por asnjëherë nuk është emëruar në asnjë institucion. Një qasje e tillë po shkatërron institucionet siç po shohim me Postën. Ne nuk kemi heqë dorë nga Kosova sepse besojmë në qytetari aktive e cila do të kërkojë llogari te të përzgjedhurit e saj. Besojmë se vetëm me profesionalizëm do të përmirësohet qeverisja e saj. Pajtohem me kryetarin që Kosova duhet ta bëjë këtë punë vetë. Pajtohem me kryeministrin që thotë se konsolidimi i shtetit buron nga ne", ka thënë O'Connell.

Edhe kryeparlamentari Kadri Veseli ka kritikuar ashpër abuzimin e njerëzve të pushtetshëm për emërimet politike në pozita të institucioneve të pavarura. Ai ka thënë se institucionet e shtetit janë servis i qytetarëve dhe që shërbimet të jenë efikase dhe të drejta, është e domosdoshme që të jenë profesionale. "Ky projekt ka ecur tre vjet dhe ka pasur rezultate të cilat janë për t'u evidentuar. Falënderoj edhe kompaninë angleze. Por, në çdo matje të besimit qytetar ne shohim që ka ulje të tij, edhe në agjencitë e pavarura, edhe në ndërmarrjet publike. Por, për fat të keq, edhe brenda institucioneve tona. Pra, duhet bërë më shumë, dhe këtë duhet ta bëjmë vetë ne, duke qenë më përgjegjës para ligjit, para etikës dhe para qytetarëve, duke dëshmuar se mund ta ndërtojmë shtetin dhe të krijojmë besim më të madh te qytetarët tanë", ka thënë Veseli.

Ai i ka ftuar të gjithë përfaqësuesit e pushtetit që t'i ndalin abuzimet dhe përdorimin e pushtetit për punësime politike pa meritë. "Duhet ndalur praktika që kush ka pushtetin më afër t'i punësojë njerëzit e vet. Disa po i punësojnë nga tre-katër veta dhe nuk po mërziten fare. Këta njerëz duhet të ndalen dhe do t'i ndalim. Inkurajoj shoqërinë civile dhe mediat, por edhe bartësit e institucioneve, që të tregohen më të guximshëm dhe më të zëshëm për t'i ndalur njerëzit e tillë, ngase do të na e shkatërrojnë perspektivën dhe do të na ikin shumë të rinj e të reja", ka thënë ai, duke shtuar se Kosova është me fat që ekspertizën shumëvjeçare britanike e kemi dhuratë dhe këtë duhet ta çmojmë, por edhe nderojmë më punë të mirë dhe të ndershme. "Vetëm në këtë mënyrë ne e avancojmë edhe vetëdijen tonë dhe dashurinë ndaj atdheut, por edhe respektin për mikun e çmuar të Kosovës, Britaninë e Madhe", ka thënë Veseli.

Kurse kryeministri Ramush Haradinaj ka deklaruar se sot po e shënojnë vitin e tretë të partneritetit me Britaninë e Madhe si shtet mik i Kosovës në të gjitha proceset e rëndësishme tona, tani edhe duke e përkrahur objektivin e kësaj qeverie për fuqizimin e qeverisjes së mirë, transparencës dhe llogaridhënies në institucione publike. "Përmes një partneriteti implementues Ambasada e Britanisë ka ndihmuar në kthimin e besimit në organet publike, por edhe rekrutimin në pozita të larta të shërbimit civil, duke e parandaluar nepotizmin dhe duke e konsoliduar transparencën, meritokracinë dhe qeverisjen e mirë. Mirëpo duhet ta pranojmë se kemi edhe lëshime, edhe dëme me të cilat duhet të përballemi", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke e falënderuar Ambasadën e Britanisë për përkrahjen që këto lëshime dhe të meta t'i trajtojë.

Ndër të tjera, Haradinaj ka sqaruar se deri më tani janë gjithsejtë 44 pozita të larta drejtuese të realizuara përmes partneritetit me Ambasadën e Britanisë në vjetët e fundit dhe janë pajtuar edhe për pozita të cilat do të realizohen për periudhën e ardhshme. "Kuptohet, demokracia dhe qeverisja e mirë janë më shumë se qëllime në vete, janë procese. Zhvillimi dhe konsolidimi i vendit duhet të burojë nga ne, nga vetëdija jonë dhe ende kemi punë për të bërë", ka theksuar Haradinaj.

Studentët e UP-së bëhen pjesë e garës ndërkombëtare të frankofonisë

PRISHTINË, 18 MARS (ER) - Profesorët dhe studentët e Departamentit të Frëngjishtes në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" këtë fundjavë u bënë pjesë e një gare ndërkombëtare të frankofonisë në kuadër të Muajit të Frankofonisë. Për herë të dytë Qendra Universitare Frankofone (QUF) e UP-së bëri që Kosova të garojë me 88 shtete të tjera në garën e leximit.

Që nga ora 10:00 deri në 15:00 studentët tanë kishin për detyrë ta përfundonin leximin e librit "Teodora e lumenjve" të autorit J-M Turine. E ky libër, sipas profesoreshës Valbona Gashi-Berisha, njëherësh koordinatore e QUF-it, merret një ditë para se të fillojë kjo ngjarje. "Librin zakonisht e marrim një ditë para se të mbahet aktiviteti, kështu që leximi është spontan", ka thënë Berisha.

Të pranishëm në këtë aktivitet të mbajtur në Fakultetin e Filologjisë ishin edhe përfaqësues nga Ambasada e Francës në Kosovë.

Qendra Universitare Frankofone është themeluar në shkurt të vitit 2018. Që nga atëherë kjo qendër ka organizuar aktivitete të shumta në funksion të promovimit të gjuhës frënge te stafi dhe studentët e UP-së.

Flet për "Epokën e re", Fatmir Matoshi

Taksa duhet të shq

- Taksa në raport me Serbinë është e merituar, por në raport me kërkesën e miqve tanë duhet të shqyrtohet

Anëtari i Kryesisë së Aleancës Kosova e Re (AKR), njëherësh ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka thënë se taksa është vendim meritor për Serbinë dhe Bosnje e Hercegovinën, por në raport me kërkesën e miqve duhet të shqyrtohet. Ai ka theksuar se AKR-ja nuk pret që taksa t'i dëmtojë raportet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA-në) dhe Bashkimin Evropian (BE-në). Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Matoshi ka deklaruar se secili subjekt politik para prishjes së raporteve me ShBA-në do të duhej ta zgjedhte largimin nga qeveria. Duke folur për funksionimin e koalicionit qeverisës, Matoshi ka thënë se deri më tani qeveria ka kryer punë të mira dhe, sipas tij, AKR-ja ka arsyetuar besimin e marrë në këtë qeveri

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 18 MARS - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka thënë të hënën se, pavarësisht prej sfidave, situata është stabile në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se 2019-a është vit i ekonomisë dhe qeveria është e përkushtuar në këtë drejtim. "Kosova në muajt e fundit ka shënuar avancim të dukshëm në shumë sfera. Kemi pasur funksionim të avancuar të Kuvendit të Kosovës dhe kjo është meritë e të gjithë deputetëve", është shprehur Matoshi. Ai ka thënë se taksa është vendim meritor për Serbinë dhe Bosnje e Hercegovinën, por në raport me kërkesën e miqve duhet të shqyrtohet.

Megjithatë, sipas Matoshit, AKR-ja nuk pret që taksa t'i dëmtojë raportet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimin Evropian (BE). "Taksa në raport me Serbinë është e merituar, por në raport me kërkesën e miqve tanë duhet të shqyrtohet. Aleanca Kosova e Re (AKR) nuk pret që taksa t'i dëmtojë raportet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe partnerët tanë të tjerë nga Bashkimi Evropian (BE). Besoj se secili subjekt politik para prishjes së raporteve me ShBA-në do të duhej ta zgjedhte largimin nga qeveria", ka deklaruar ai.

Ministri Matoshi ka folur për funksionimin e koalicionit qeverisës duke thënë se deri më tani ka bërë punë të mira. Ai ka thënë se koalicioni qeverisës synon ta çojë mandatin deri në fund. "Me të gjithë partnerët e koalicionit

yrtohet

kemi raporte korrekte të punës dhe bashkëpunimit, kemi kryer punë shumë të mira për vendin, pavarësisht prej sfidave dhe problemeve që kjo qeveri ka pasur gjatë funksionimit të saj. Ne e kemi marrë mandatin për ta qeverisur vendin për katër vjet dhe është normale që ky mandat të shkojë deri në afatin e përcaktuar për zgjedhjet e ardhshme", është shprehur Matoshi, duke shtuar se AKR-ja ka arsyetuar besimin e marrë në këtë qeveri.

"Epoka e re": *Z. Matoshi, si i komentoni zhvillimet politike në vend?*

Matoshi: Në përgjithësi kemi një situatë stabile në shumë aspekte të funksionimit të shtetit dhe institucioneve të vendit. Ky është vit i ekonomisë, i shpallur edhe nga kryeministri dhe përkushtimi i qeverisë është në këtë drejtim. Kosova në muajt e fundit ka shënuar avancim të dukshëm në shumë sfera. Kemi pasur funksionim të avancuar të Kuvendit të Kosovës dhe kjo është meritë e të gjithë deputetëve. Tanimë kemi themeluar ushtrinë tonë, dhe ky ishte një proces i menaxhuar mjaft mirë, ndërkohë tema që ka mbizotëruar është vendosja e taksës ndaj produkteve nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina.

"Epoka e re": *Sipas Aleancës Kosova e Re (AKR), cila është zgjidhja e duhur për të dalë nga situata e krijuar pas vendosjes së taksës ndaj produkteve serbe dhe boshnjake?*

Matoshi: Taksa ishte dhe është e merituar për Serbinë dhe Bosnje e Hercegovinën. Është vendim sovran i Kosovës, i cili është marrë ngaqë ishim të detyruar për një veprim të këtillë për t'i dhënë përgjigje agresionit të Serbisë në raport me integrimin e Kosovës dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare. Prandaj Serbia e meriton këtë taksë plotësisht.

"Epoka e re": *Në rast se vihen në pikëpyetje marrëdhëniet me ShBA-në, a është e gatshme AKR-ja ta braktisë Qeverinë Haradinaj?*

Matoshi: Taksa në raport me Serbinë është e merituar, por në raport me kërkesën e miqve tanë duhet të shqyrtohet. Aleanca Kosova e Re (AKR) nuk pret që taksa t'i dëmtojë raportet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe partnerët tanë të tjerë nga Bashkimi Evropian (BE). Unë besoj se secili subjekt politik para prishjes së raporteve me ShBA-në do të duhej ta zgjedhte largimin nga qeveria.

"Epoka e re": *Si e vlerësoni bashkëqeverisjen e deritashme dhe sa ka gjasa që ky koalicion ta çojë deri në fund mandatin?*

Matoshi: Me të gjithë partnerët e koalicionit kemi raporte korrekte të punës dhe të bashkëpunimit, kemi kryer punë shumë të mira për vendin, përkundër sfidave dhe problemeve që kjo qeveri ka pasur gjatë funksionimit të saj. Ne e kemi marrë mandatin për të qeverisur vendin për katër vjet dhe është normale që ky mandat të shkojë deri në afatin e përcaktuar për zgjedhjet e ardhshme.

"Epoka e re": *Z. Matoshi, ndonëse AKR-ja ka pasur numër të vogël të deputetëve, ka marrë hise të madhe në qeverisje. Sa po arsyetohet kjo gjë?*

Matoshi: Shtëpitë janë të mëdha, por brenda tyre legalisht hyhet vetëm me çelës, prandaj AKR-ja ka qenë çelësi për themelimin e këtyre institucioneve dhe marrëveshja politike për qeverinë ka qenë shumë e vullnetshme nga të gjitha palët. AKR-ja ka arsyetuar besimin e marrë në këtë qeveri dhe ka punuar pandërprerë konform këtij besimi. Diplomacia e Kosovës është përballur me një fushatë agresive nga Serbia dhe kultivimi i raporteve të mira me shumë vende e ka shpëtuar Kosovën nga një defaktorizim ndërkombëtar për të cilin Serbia ka investuar shumë. Mjedisi është tanimë prioritet i kësaj qeverie dhe ka pasur zhvillime shumë të mira në këtë drejtim. Ekonomia që, po ashtu, drejtohet nga AKR-ja, ka marrë prioritetin e Qeverisë së Kosovës.

Tahiri: Kosova, vend prijës në rajon sa i përket kompensimit të viktimave të krimit

Prishtinë, 18 mars (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka marrë pjesë të hënën në takimin publik për koncept dokumentin për fushën e kompensimit të viktimave të krimit. Ministri Tahiri ka deklaruar se të drejtat e viktimave të krimit janë avancuar me ndryshimin e Projekt Kodit të Procedurës Penale, që aktualisht është në Kuvendin e Kosovës që, sipas ministrit Tahiri, mundëson trajtim të dinjitetshëm ndaj viktimave, duke u garantuar atyre të drejta në pajtim me standardet më të avancuara ndërkombëtare. "Krahas të drejtave për të marrë informata mbi veprën penale, për ofrimin e ndihmës mjekësore, përkrahjes psikologjike dhe strehimit alternativ, i kemi kushtuar vëmendje të madhe të drejtës së pakontestueshme për përfaqësim ligjor dhe ndihmë juridike të mirëfilltë. Edhe e drejta për kompensim dhe rimbursim të shpenzimeve të bëra si rezultat i pjesëmarrjes së tij/saj në procedurën penale është në linje të plotë me vullnetin tonë për ta fuqizuar mekanizmin e kompensimit të viktimave të krimit", ka thënë ministri Tahiri.

Sipas ministrit Tahiri, përveç Projektkodit të Procedurës Penale, avancimi i të drejtave të krimit do të bëhet edhe përmes rishikimit të Ligjit nr. 05/L-036 për kompensimin e viktimave. "Në funksion të Kompensimit të Viktimave të Krimit, Republika e Kosovës nga viti 2017 ka filluar kompensimin e viktimave dhe sot kemi programin funksional dhe e themi me mburrje se jemi vend prijës në rajon sa i përket kompensimit të viktimave të krimit, mirëpo ne nuk do të mjaftohemi me kaq. Do të punojmë që të krijojmë norma dhe mekanizma që jetën viktimave t'ua bëjmë më të lehtë", ka thënë Tahiri.

Për rëndësinë e avancimit të të drejtave për viktimat e krimit ka folur edhe Lana Owens Moreton nga Ambasada e ShBA-së në Prishtinë, ndërsa kryetarja e Komisionit për Kompensimin e Viktimave, Nesrin Lushta, ka prezantuar sfidat gjatë implementimit të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

Bakija-Deva: Rritja e pjesëmarrjes së grave në jetën publike, element kyç për zhvillim e shtetit

PRISHTINË, 18 MARS (ER) - Zëvendësministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Burbuqe Bakija-Deva, ka thënë se ka qenë e nderuar ta pranojë certifikatën nga ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, për programin "Eliminimi i barrierave për mundësi të barabarta", në ceremoninë e përmbylljes së projektit të KUSA-s, të financuar nga Ambasada Amerikane në Kosovë. "Askush nuk duhet të dyshojë në faktin se gratë, mbi bazën e dinjitetit të tyre të barabartë me të burrave, kanë të drejtë të plotë për t'u futur aktivisht në çdo aspekt të jetës publike. Mundësitë dhe të drejtat e barabarta në procesin e vendimmarrjes për gratë në Kosovë vazhdojnë të mbeten ende një sfidë e madhe. Ekziston nevoja e marrjes së veprimeve të nevojshëm për të krijuar diversitet gjinor me qëllim të zhvillimit të përgjithshëm të shoqërisë", ka shkruar Bakija-Deva në llogarinë e vet në "Facebook".

Ajo ka thënë se barazia gjinore në pjesëmarrjen politike dhe publike është aspekt fundamental i qeverisjes demokratike moderne. "Rritja e pjesëmarrjes së grave në jetën publike përbën një element kyç për zhvillim dhe demokratizim të një vendi. Meshkujt dhe femrat duhet të kenë të drejta dhe mundësi të barabarta për pjesëmarrje të plotë në të gjitha aspektet dhe nivelet e proceseve. Mungesa e mundësive të barabarta për gratë në këtë fushë është duke e penguar potencialin e gjysmës së popullsisë për të marrë një rol aktiv në fushat e politikave zhvillimore, atyre ekonomike, sociale si dhe fusha të tjera të jetës shoqërore", ka thënë zëvendësministrja Bakija-Deva.

Ajo ka thënë se përfshirja e grave në të gjitha aspektet e jetës politike është e rëndësishme jo vetëm sepse gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë, por sepse arritja e pjesëmarrjes së balancuar të grave dhe burrave në vendimmarrjen politike dhe publike është çështje e zotërimit të plotë të të drejtave të njeriut, drejtësisë sociale, si dhe një kusht i nevojshëm për funksionim më të mirë të një shoqërie demokratike.

Pajisjet e reja lehtësojnë punën në Klinikën e Gjinekologjisë

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 MARS - Puna për mjekët në Klinikën e Gjinekologjisë është lehtësuar qëkur kanë pranuar thika ultrasonike, të cilët e bëjnë intervenimin më të sigurt në rastet e komplikuara operative. Me to ndërhyrja kryhet më lehtë e më shpejt dhe, veç prerjes, bëhet edhe qepja, pa pasur nevojë për intervenim me penj e gjilpërë.

Shefi i Operativës në Klinikën e Gjinekologjisë, Zef Ndreja, ka thënë se thikat ultrasonike kanë qenë të domosdoshme, pasi që në mungesë të tyre ishin të detyruar që rastet t'i punonin me dorë. "Është një lehtësim i madh si për shkurtim të kohës, po ashtu edhe për procedurën e sigurisë. Domethënë, gjakderdhja është më e vogël dhe siguria është më e madhe në punë. Prej kur ka ardhur është përdorur në 27 raste. Derisa s'e kishim këtë aparaturë jemi detyruar të punojmë vetëm me dorë. Shumë raste janë vështirësuar, ka pasur gjakderdhje më shumë, koha e përmirësimit ishte më e vështirë. Kështu që, kjo e lehtëson punën shumë", ka thënë Ndreja.

Klinika e Gjinekologjisë është pajisur me thika ultrasonike vitin e shkuar.

Për ta rritur cilësinë e shërbimeve, Ministria e Shëndetësisë dhe ShSKUK njëkohësisht e kanë furnizuar këtë klinikë edhe me histeroskop, laparaskop, tavolina gjinekologjike-operative dhe llamba operative për të gjitha sallat.

Hapet ekspozita 'Zani i shpirtit' nga Dëbora Hetemi

PRISHTINË, 18 MARS - Në Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Bogdani" të hënën është hapur ekspozita 'Zani i shpirtit" nga artistja në moshë të re, Debora Hetemi, e cila për herë të parë ka publikuar 30 piktura.

Dëbora Hetemi, 16-vjeçare, e cila është në Shkollën e Artit "Çesk Zadeja" në Ferizaj, ka thënë se kjo ekspozitë është mjaft me rëndësi, që tregon të gjithë punën e saj që nga mosha nëntëvjeçare. "Sot kjo ekspozitë e imja do të përmbajë gjithsej 30 piktura dhe punime të cilat janë të punuara me ngjyra dhe gjashtë janë të punuara me laps. Kjo ekspozitë është mjaft e rëndësishme për mua pasi e tregon gjithë rrugëtimin që e kam bërë gjatë gjithë këtyre viteve, nga hapat e mi të parë e deri më sot", ka thënë Hetemi.

Synimet e Dëborës janë të mëdha, të një artisteje me vlerë. Ajo ka thënë se krejt këto punime nuk do të arriheshin për t'u realizuar pa mbështetjen e prindërve të saj. "Prej institucioneve nuk kisha me thënë se kam pasur përkrahje shumë të madhe, përveç shkollës së artit ku jam nxënëse, me këshilla për artin. Mirëpo, mbështetjen më të madhe ma ka dhënë familja, e posaçërisht prindërit", ka deklaruar Hetemi.

Kjo ekspozitë do të jetë e hapur deri më 22 mars.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, u shkruan letër udhëheqësve të shtetit lidhur me procesin e legalizimit të armëve

Kërkohet mbështetje nga Presidenca, Kuvendi dhe Qeveria për procesin e legalizimit të armëve

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, i ka njoftuar përmes një letre krerët shtetërorë lidhur me procesin e legalizimit të armëve. Ai ka bërë me dije se deri më sot janë 508 kërkesa për legalizim të armëve. Në këtë kontekst, Ministria e Punëve të Brendshme ka lëshuar 216 pëlqime për legalizim të armëve. Zeka ka kërkuar mbështetje edhe nga Presidenca, Kuvendi dhe Qeveria për procesin e legalizimit të armëve

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prishtinë, 18 mars - Zëvendësministër i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, u ka dërguar letër krerëve shtetërorë, Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Ramush Haradinajt, lidhur me procesin e legalizimit të armëve. Kjo kërkesë e zëvendësministrit Zeka ka të bëjë me mbështetjen publike dhe të fuqishme të procesit të legalizimit të armëve në Republikën e Kosovës. Zeka ka thënë se procesi i legalizimit, i iniciuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe i mbështetur nga Qeveria e Kosovës, është pjesë përbërëse e interesit dhe përpjekjeve të shtetit të Kosovës për rritjen dhe forcimin e sigurisë publike në Kosovë. "Keqpërdorimi i armëve dhe trafiku i tyre i paligjshëm nuk janë shqetësim vetëm për sigurinë publike në Kosovë, por edhe për rajonin, duke qenë se nxisin krimin e organizuar dhe terrorizmin, ndërkohë që siguria jonë është e lidhur ngushtë me sigurinë dhe stabilitetin e Bashkimit Evropian. Kjo është hera e parë që institucionet e Kosovës e kanë lansuar vetë këtë proces, dhe deri më tash kemi parë interes të madh, por kërkohet edhe mbështetja juaj për promovimin e legalizimit të armëve, në mënyrë që përpjekjet tona të jenë vërtet të suksesshme dhe të sigurohet interesi ynë i përbashkët për një Kosovë më të sigurt", ka thënë Zeka.

Ai ka bërë me dije se deri më sot janë 508 kërkesa për legalizim të armëve dhe Ministria e Punëve të Brendshme ka lëshuar 216 pëlqime për legalizim të armëve. "Jemi të vetëdijshëm se ka ende mundësi që të përmirësohet procesi. Shprehim angazhimin tonë për vazhdimin e punës për trajtimin e këtyre hendekëve dhe për zbatimin në të ardhmen të mësimeve të nxjerra. Pasojat humanitare të flukseve të paligjshme të këtyre armëve mund të jenë shkatërruese, duke rezultuar në viktima civile dhe duke penguar zhvillimin. Për këtë arsye është e domosdoshme që çështja e armëve të lehta dhe të vogla të përfshihet në diskursin publik si dhe të punojmë së bashku për parandalimin efektiv të krimeve të lidhura me armët dhe për adresimin e pasojave të flukseve të paligjshme të armëve", ka thënë ai.

Zeka ka njoftuar përfaqësuesit e shtetit se në vitin 2018, nën kujdesin e Gjermanisë dhe të Francës u lansua një iniciativë e përbashkët për udhërrëfyesin për zgjidhjen e qëndrueshme të posedimit, keqpërdorimit dhe trafikimit të paligjshëm të legalizimit të armëve të vogla dhe municioneve të tyre në Ballkanin Perëndimor, e cila u miratua në Samitin e Ballkanit Perëndimor në Londër më 10 korrik 2018.

Kjo iniciativë, sipas Zekës, përqendrohet në reduktimin e ndjeshëm të armëve të zjarrit në posedim të paligjshëm në Ballkanin Perëndimor. "Bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, në vendet ku incidentet janë të pakta me armë zjarri të poseduara në mënyrë të ligjshme, ose aty ku bëhet kalimi nga një sistem i regjistrimit të armëve në tjetrin, siç është rasti edhe në Kosovë, reduktimi i armëve të zjarrit në posedim të paligjshëm mund të realizohet përmes kufizimit të kërkesës dhe furnizimit, përmes konfiskimit dhe dorëzimit vullnetar, përmes çaktivizimit, sidomos përmes legalizimit. Nëpërmjet ofrimit të këtyre opsioneve, të gjitha metodat janë të disponueshme në mënyrë që qytetarët ta respektojnë ligjin. Ky proces është në harmoni me direktivën e BE-së për armët e zjarrit 91/477/EEC, të ndryshuara në vitin 2018, dhe kjo direktivë përcakton një masë shoqëruese për tregun e brendshëm. Kjo vendos ekuilibrin mes: 1) angazhimit për të siguruar njëfarë lirie të lëvizjes për disa armë zjarri dhe komponentët e tyre esencialë; dhe 2) nevojës për ta kontrolluar këtë liri duke përdorur garancitë e sigurisë së përshtatshme për ato produkte. Ju ftoj dhe jam në dispozicionin tuaj për ta diskutuar në mënyrë më ta hollësishme fushatën e legalizimit dhe vizionin tonë të përbashkët për mënyrën e trajtimit të kërcënimit të këtyre armëve dhe municioneve të tyre", ka thënë zëvendësministri Zeka.

Kurti: Zgjedhjet e reja janë aq shumë të nevojshme

Prishtinë, 18 mars (ER) - "Çdo i treti banor i Kosovës ka qasje të vështirë në kujdesin shëndetësor, kurse çdo i pesti nuk kërkon shërbime edhe në rast të sëmundjes për shkaqe ekonomike", kështu ka thënë të hënën kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka theksuar se vdekshmëria e foshnjave në Kosovë është katërfish më e lartë sesa mesatarja në Bashkimin Evropian. "Çdo i nënti fëmijë në Kosovë punon, ndërkaq vetëm çdo e teta grua ka një vend pune. Kosova i ka 34 ligje për mbrojtje sociale, por pak zbatohen. Shteti ynë nuk vuan nga ligjet e këqija sa nga pushteti i keq dhe institucionet e dobëta. Investimet në ekonomi zhvillimore kanë rënë, kurse korrupsioni nëpër ndërmarrje publike është rritur", ka thënë Kurti. Ai ka theksuar se institucionet e shtetit janë përgjigjja për nevojat e shoqërisë dhe të drejtat e qytetarëve, e jo shans për interesat private dhe partiake. "Ndryshimi tashmë nuk është zgjedhje, por nevojë jetike. Andaj, zgjedhjet e reja janë aq shumë të nevojshme", ka thënë lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti.

Miratohet Rregullorja për transformimin e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore me negocim të drejtpërdrejtë

EPOKA E RE A. MAVRAJ

Prishtinë, 18 mars - Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) ka miratuar rregulloren për shitjen e aseteve të caktuara të ndërmarrjeve shoqërore me negocim të drejtpërdrejtë.

Rregullorja në rastin konkret përbën akt nënligjor të Agjencisë, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e aseteve me natyrë specifike të cilat evidentohen në emër të ndërmarrjeve shoqërore, përderisa të njëjtat, në kuptim të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përfshihen nën juridiksionin e kësaj Agjencie.

"Bordi i Drejtorëve mori një vendim të tillë, duke pasur parasysh faktin se ndaj ndërmarrjeve shoqërore dhe/ose aseteve të tyre vazhdojnë të evidentohen një numër i konsiderueshëm i pretendimeve pronësore me natyrë potencialisht kontestuese, përderisa konstatimi i vlefshmërisë së këtyre pretendimeve kërkon një masë të konsiderueshme të kohës dhe punës profesionale. Duke iu referuar nenit 15 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Bordi i Drejtorëve ka kompetencë që në harmoni me legjislacionin në fuqi t'i shqyrtoj të gjitha ato kërkesa dhe/ose pretendime me natyrë specifike, të cilat kualifikohen si të tilla, kurse paraqesin pengesë në procesin e transformimit pronësor", është bërë me dije në njoftimin për media të AKP-së.

AKP-ja inkurajon subjektet e ndryshme (fizike dhe/ose juridike) se kanë të drejtë ta iniciojnë procesin e negocimit drejtpërdrejt me agjencinë nëse paraprakisht konstatohet se pretendimet e tyre kualifikohen si raste specifike (baza juridike e pretendimeve, natyra komplekse e çështjes, origjina e pretendimeve e tjera, sipas Rregullores së cituar si më sipër) dhe iu referohen pasurive të ndonjë ndërmarrje shoqërore, e cila, sipas legjislacionit në fuqi, bie nën administrimin e këtij institucioni. "Në pajtim me legjislacionin në fuqi, inicimi i procedurës administrative për çështjet e shpjeguara si më sipër, bëhet sipas detyrës zyrtare të Agjencisë në emër dhe për llogari të ndërmarrjeve shoqërore dhe me kërkesën e palëve të interesuara, të cilat në Zyrat Rajonale dhe/ose në faqen zyrtare të Agjencisë mund të pajisen me Formularin e kërkesës për inicimin e procedurës, i cili përmban elementet qenësore të kërkesës dhe disa prej udhëzimeve parimore", është theksuar në këtë njoftim.

Për mbështetje, këshilla dhe shpjegime eventuale qytetarët kanë të drejtë t'u drejtohen zyrave rajonale dhe/ose zyrës qendrore të Agjencisë, kurse kërkesa e kompletuar dorëzohet drejtpërdrejtë në Zyrën Rajonale në territorin e së cilës gjendet patundshmëria.

Verërat e Kosovës promovohen në Panairin 'ProWein 2019' në Gjermani

Prishtinë, 18 mars (ER) - Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Kapllan Halimi, së bashku me drejtorin e Departamentit të Vreshtarisë dhe Verëtarisë, Bekim Hoxha, po marrin pjesë në Panairin Ndërkombëtar të Verës 'ProWein 2019', i cili është duke u mbajtur në Dusseldorf të Gjermanisë.

Në këtë panair produktet e tyre janë duke i promovuar edhe bodrumet e verërave kosovare, siç janë: 'Bodrumi i Vjetër', 'Stone Castle', 'Illyrian Winery', 'Kosova Wine' dhe 'Suhareka Wine'.

Gjatë kësaj kohe këto bodrume do ta kenë mundësinë që produktet e veta t'i promovojnë para shumë blerësve ndërkombëtarë, e me këtë rast do të kenë mundësinë të krijojnë bashkëpunim për së afërmi me kompani të ndryshme në tregun ndërkombëtar.

Pjesëmarrja e këtyre bodrumeve në këtë panair është mundësuar falë mbështetjes së Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e cila gjatë tërë kohës është e fokusuar për promovimin e prodhimeve bujqësore edhe jashtë vendit.

Panairi Ndërkombëtar 'ProWein2019' është hapur më 16 mars dhe do të zgjasë deri më 20 mars 2019.

Lansohet aplikacioni mobil për prezantimin e të dhënave mbi cilësinë e ajrit

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Zyra e BE-së në Kosovë kanë lansuar të hënën aplikacionin mobil për prezantimin në kohë reale të të dhënave mbi cilësinë e ajrit në Kosovë. Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka bërë me dije se qytetarët do të mund të kyçen në aplikacion duke klikuar në stacionet prej nga do të informohen për cilësinë e ajrit

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 18 MARS - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, së bashku me shefin e Seksionit për Bashkëpunim në Zyrën e BE-së në Kosovë, Luigji Brusa, të hënën kanë lansuar aplikacionin mobil për prezantimin në kohë reale të të dhënave mbi cilësinë e ajrit në Kosovë.

Në një konferencë për media, ministri Matoshi ka thënë se ky aplikacion do t'u mundësojë qytetarëve të Republikës së Kosovës ta shohin cilësinë e ajrit në kohë reale. "Me qëllim të informimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës mbi cilësinë e ajrit nga stacionet monitoruese që kemi, me përkrahjen e Komisionit Evropian, sot po lansojmë aplikacionin për Android dhe IOS, përmes të cilit do të paraqiten të dhënat për cilësinë e ajrit në kohë reale. Krahas masave dhe veprimeve që po ndërmarrim për reduktimin e ndotjes së ajrit, ky aplikacion do të ofrojë informata mbi nivelin e ndotjes dhe pasojat në shëndet", ka thënë Matoshi.

Ai ka bërë me dije se qytetarët do të mund të kyçen në aplikacion duke klikuar në stacionet prej nga do të informohen për cilësinë e ajrit. "Ne do të mundohemi si ministri të angazhohemi edhe më shumë për ta rritur cilësinë e ajrit në vendin tonë", ka thënë ai.

Ministri Matoshi ka falënderuar Komisionin Evropian për mbështetje për krijimin e këtij aplikacioni si dhe donatorët e tjerë si MCC-në për rehabilitimin e rrjetit ekzistues për monitorimin e cilësisë së ajrit si dhe softuerin e përhershëm për prezantimin e të dhënave për cilësinë e ajrit, parashikimin e cilësisë së ajrit dhe ndikimin në shëndet. Po ashtu, ministri ka falënderuar edhe JICA japoneze e cila është duke bërë studimin për identifikimin e ndotësve të ajrit si dhe UNDP-në me të cilën MMPH-ja është duke përgatitur një fushatë vetëdijesuese për reduktimin e ndotjes së ajrit.

Ndërsa shefi i Seksionit për Bashkëpunim në Zyrën e BE-së në Kosovë, Luigji Brusa, ka thënë se përmes këtij aplikacioni qytetarët e Republikës së Kosovës mund ta shohin cilësinë e ajrit në mënyrë transparente. "Hapi i parë është të shohim se çka po ndodh me cilësinë e ajrit dhe çfarë ajri po thithim. Natyrisht se tani është me rëndësi që qeveria të ndërmarrë masa që ta përmirësojë kualitetin e ajrit në mënyrë që t'i eliminojnë burimet e ndotjes", ka thënë Brusa. Sipas tij, BE-ja është duke investuar në Kosovë për ndërrimin e filtrave të 'Kosovës B' në zgjerimin e Kogjenerimit në mënyrë që të reduktohet shfrytëzimi i qymyrit në Prishtinë. Ndërsa Shkumbin Shala nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka prezantuar formën e përdorimit të aplikacionit i cili mund të shkarkohet në telefonat Android dhe IOS.

Ministrja Hoxha: Të rinjtë do të përkrahen me programet për ekonominë digjitale

PRISHTINË, 18 MARS (ER) - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka takuar të rinjtë, shërbyes civilë nga gjashtë vendet e rajonit, të cilët kanë qenë pjesë e pilot-projektit në kuadër të procesit të Berlinit dhe Agjendës së Konektivitetit të BE-së për Ballkanin Perëndimor. Hoxha në këtë takim ka potencuar ndihmën nga IPA 2017 dhe IPA 2018 për ekonominë digjitale, nëpërmjet skemave të granteve për biznese fillestare, ku fokusi është te teknologjia e informimit dhe komunikimit.

Ministrja Hoxha ka thënë se gjatë rishikimit të listës prioritare të projekteve do të shtohet sektori i ekonomisë digjitale, që i mundëson Kosovës të aplikojë në kornizën investuese të Ballkanit Perëndimor me projekte të kësaj fushe.

Muharremaj kërkon mbylljen e kazinove në Komunën e Suharekës

Suharekë, 18 mas (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, pas vrasjes së 35-vjeçarit në një kazino, ka kërkuar mbylljen e të gjitha kazinove në territorin e kësaj komune. Muharremaj ka bërë me dije se për këtë çështje ka urdhëruar organet përgjegjëse që t'i ndërmarrin veprimet e duhura. "Sot kam dhënë urdhër për Drejtorinë e Inspeksionit dhe kam kërkuar mbështetjen e Policisë në Suharekë, për një operacion verifikimi në të gjitha këto objekte ku zhvillohen lojërat e fatit. Në emër të qytetarëve te Komunës së Suharekës kërkoj nga institucionet përkatëse t'i marrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për mbylljen e kazinove në Komunën e Suharekës. Si kryetar i Komunës së Suharekës do të jem afër qytetarëve, që për aq sa më mundëson ligji të jem në mbrojtjen e interesave tuaja", ka thënë Muharremaj pas takimit me përfaqësuesit e organeve të rendit.

Gjakova rikthehet në Telekomin e Kosovës

Gjakovë, 18 mars (ER) - Komuna e Gjakovës është rikthyer të hënën në Telekomin e Kosovës, duke nënshkruar kështu kontratë trevjeçare me kompaninë më të madhe telekomunikuese në vend. Telekomi i Kosovës është duke vazhduar realizimin e strategjisë për rikthimin e fuqishëm, në kuadër të së cilës është edhe rikthimi i institucioneve, të cilat deri më sot nuk ishin pjesë e kompanisë sonë.

Drejtori i shitjes në Tekekomin e Kosovës, Demir Limaj dhe kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, kanë nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim të ndërsjellë, në një afat trevjeçar. Me rastin e nënshkrimit të kontratës, Limaj ka pohuar se për Telekomin e Kosovës çdo konsumator është i vlefshëm, por rikthimi i konsumatorëve të humbur ka vlerë të shtuar. "E kemi shumë të qartë se ne operojmë në kushte jo të barabarta me konkurrencën, por sa i përket cilësisë së produkteve, jemi të pakonkurrencë dhe kjo ka bërë që edhe Komuna e Gjakovës të rikthehet në Telekomin e Kosovës", ka thënë Demir Limaj.

Ndërsa kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka shprehur besimin e plotë në shërbimet dhe produktet e Telekomit të Kosovës. "Pa dyshim se ne si institucion kemi nevojë për shërbime dhe produkte shumë cilësore, andaj përzgjedhja e Telekomit është shumë e qëlluar për ne", ka thënë Gjini.

E diela, ditë pushimi, po respektohet nga bizneset në Mitrovicë

Mitrovicë, 18 mars - Të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve të Komunës së Mitrovicës, e cila është drejtuar nga nënkryetari Faruk Mujka. Në këtë mbledhje janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje të rëndësishme nga fushëveprimi i Bordit dhe drejtorive komunale. Në këtë mbledhje, drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Egzon Jashari, ka njoftuar ekzekutivin se është mbajtur mbledhja e parë e komisionit për verifikimin e përmbushjes së marrëveshjeve kontraktuare nga subjektet afariste në zonën e lirë ekonomike, i cili tha se ky komision ka hartuar planin e veprimit që është i ndarë në tri faza: fazën e grumbullimit të dokumentacionit, fazën e verifikimit në terren dhe fazën e përpilimit të raportit me rekomandime.

Ndërsa drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, ka bërë me dije se edhe gjatë këtij vikendi inspektorët komunalë, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, kanë inspektuar subjektet afariste lidhur me vendimin për respektimin e orarit të punës. Ai ka thënë se vendimi i kryetarit Bahtiri që dita e diel të jetë ditë pushimi për të gjitha bizneset në Mitrovicë është duke u respektuar në përpikëri, duke u bërë kështu komuna jonë shembull për komunat e tjera.

Një temë tjetër me rëndësi e cila u diskutua në mbledhjen e sotme ishte edhe niveli i pastërtisë në qytet, me ç'rast ekzekutivi u pajtua që pastërtia të jetë në nivelin e duhur, të bëhet mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese, me theks të veçantë në hapësirat përgjatë Liqenit akumulues i cili ofron një atraksion të vërtetë turistik dhe frekuentohet nga një numër i madh i qytetarëve nga e gjithë Kosova.

Komuna e Prishtinës e vendosur për rend dhe rregull në sheshet e kryeqytetit

Prishtinë, 18 mars (ER) - Komuna e Prishtinës është duke vazhduar aksionin për largimin e shitësve ambulatorë dhe disa personave që lodrat e fëmijëve janë duke i përdorur për biznes në hapësirat publike të kryeqytetit. Kjo komunë ka theksuar se sheshi kryesor i kryeqytetit duhet të jetë i lirë për lëvizje. Në këtë kontekst, Komuna e Prishtinës ka bërë me dije se do të vendosë rregull në sheshet e kryeqytetit. "Sheshi i kryeqytetit është hapësirë publike dhe duhet të jetë i lirë për lëvizje. Rendi dhe rregulli po vendosen. Por, do të jetë më e lehtë nëse bëhemi qytetarë të përgjegjshëm dhe të ndërgjegjshëm!", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.

Serbët e Kosovës duhet t'i thonë jo Vuçiqit!?

Halil MATOSHI

Thirrjet e presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq drejtuar serbëve të Kosovës, për të shkuar në Beograd në mbrojtje të tij nga opozita, janë vazhdimësi e politikës së Milosheviqit. Klithjet e tij drejtuar serbëve të vendit tonë për shpëtim, dëshmojnë së pari dështimin e tij në vendosje të demokracisë në Serbi dhe së dyti, instrumentalizimin e skajshëm të qytetarëve serbë të Kosovës.

Mjerisht ata janë vënë në shërbim të kauzave të rreme nacionaliste të Aleksandër Vuçiqit dhe bandës së tij neoçetnike, që në thelb, janë përpjekje për t'u mbajtur vetë në pushtet, pa pyetur për çmimin.

Dhe natyrisht se çmimi është i lartë: Deri në serbin e fundit të Kosovës!?

Po ky Vuçiqi, si një ish-zëdhënës i regjimit kriminal të nomenklaturës milosheviqiane, për dekada të tëra abuzoi me ndjenjat e serbëve të Kosovës, manipuloi dhe i nxiti ata t'u bashkoheshin tendencave gjenocidale kundër shqiptarëve.

Është koha që pjesëtarët e komunitetit serbë të Kosovës t'i thonë jo një hegjemonizmi të ri e të pashpresë të presidentit të Serbisë, që hapur është kundër vlerave euroatlantike dhe që për ta ruajtur pushtetin totalitar mbi të gjithë serbët, është në gjendje t'i nisë drejt ndonjë tragjedie të re, duke i sakrifikuar pamëshirshëm.

Protestat e opozitës në Serbi janë çështje të brendshme të shtetit serb, ndërsa serbët kosovarë duhet t'i ndërtojnë jetët e tyre, të patrazuar nga askush, në Republikën e Kosovës dhe t'i kontribuojnë demokratizimit të shoqërisë kosovare.

Prishtina zyrtare, institucionet kosovare, u garantojnë serbëve të Kosovës një të sotme të sigurt dhe ardhmëni prosperuese këtu, në shtëpinë tonë të përbashkët.

Lojalë ndaj Prishtinës, ata janë të sigurt se nuk do të dërgohen në luftëra të pakuptimta e të përgjakshme, për ta mbrojtur pushtetin personal të kujtdo qoftë, siç i nisi "Kasapi i Ballkanit" Slobodan Milisheviq në vitet '90-ta kundër të gjithë joserbëve në rajonin tonë!?

Qytetarët e Kosovës, të komunitetit serb, duhet më në fund të vetëdijesohen politikisht dhe të shkëputen nga terri mesjetar!

Fillon kampanja e riciklimit 'Ruje, mos e gjuj'

Prishtinë, 18 mars (ER) - Në Ditën Botërore të Riciklimit, qytetarët e Kosovës, më konkretisht ata të Vushtrrisë dhe të Prishtinës, do të bëhen pjesë e projektit të riciklimit, një iniciativë nga "Coca-Cola HBC Kosova" së bashku me dhjetë partnerë, e cila synon ta rrisë vetëdijesimin rreth rëndësisë së krijimit të sistemit të duhur për menaxhimin e mbeturinave dhe rreth riciklimit në përgjithësi.

Një sërë aktivitetesh do të realizohen nën sloganin 'Ruje, mos e gjuj', me qëllim të mbledhjes dhe riciklimit të shisheve të plastikes dhe kanaçeve. Ky projekt, i cili u formalizua të hënën me nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit, do të implementohet këtë vit nga marsi deri në nëntor.

Marrëveshja e bashkëpunimit u nënshkrua në mes të dhjetë partnerëve institucionalë: Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komunës së Vushtrrisë, "Coca-Cola HBC Kosova", Qendrës së Studentëve, Kolegjit AAB, Kolegjit RIT, Green Art Centre Kosova, KRM Uniteti, Qendra për Përkrahjen e Punësimit dhe Ruajtjen e Ambientit dhe Green Eko Recycling.

Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, e ka vlerësuar shumë këtë iniciativë. Ndërkaq kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka bërë thirrje të kontribuojmë për një mjedis të pastër për brezat e ardhshëm.

Drejtori ekzekutiv i "Coca-Cola HBC Kosova", Neritan Tira, ka thënë të gjithë nga "Coca-Cola HBC Kosova" punojnë dhe jetojnë në këtë komunitet lokal. "Ne qytetarët e Kosovës duhet të demonstrojmë përgjegjësi personale për ruajtjen e mjedisit tonë për gjeneratat e ardhshme. Si kompani jemi këtu për ta mbështetur komunitetin lokal për krijimin e sistemit të duhur për menaxhimin e mbeturinave dhe për t'i vetëdijesuar qytetarët për rolin e tyre personal. Si gjithmonë do të jemi partnerë të besueshëm të komunitetit lokal të Kosovës për të siguruar një të ardhme sa më të mirë", ka thënë ai.

Sa i përket procesit të implementimit të këtij projekti, drejtoresha ekzekutive e GAC-it, Merlina Beu-Muçaj, ka theksuar se ky projekt me moton 'Ruje, mos e gjuj', e jep vetvetiu mesazhin për rëndësinë e riciklimit si vlerë ekonomike, në ato që në jetë të përditshme i quajmë mbeturina.

Partnerët e projektit 'Ruje, mos e gjuj' u zotuan ta forcojnë bashkëpunimin e tyre në mënyrë që ky projekt të shërbejë si një shembull i suksesit dhe të kontribuojë për krijimin e një sistemi të menaxhimit të mbeturinave dhe për zgjerimin e projektit në komunat e tjera gjatë në vitet e ardhshme.

Shkolla e Mesme e Mjekësisë 'Dr. Xheladin Deda' shënoi 72-vjetorin e themelimit të saj

Mitrovicë, 18 mars (ER) - Shkolla e Mesme e Lartë e Mjekësisë 'Dr. Xheladin Deda' në Mitrovicë ka shënuar të hënën 72-vjetorin e themelimit të saj. Për nder të ditës së shkollës, drejtori, mësimdhënësit dhe nxënësit e kësaj shkolle kanë organizuar një program kulturor-artistik si dhe panairin shkencor.

Në shënimin e kësaj dite ishte i pranishëm drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Iset Beka, zëvendësministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Sami Zeka, drejtori i Shkollës së Mesme të Mjekësisë 'Dr. Xheladin Deda', Gani Rama, drejtorë të shkollave të tjera, nxënës, mësimdhënës dhe prindër.

Për historikun e shkollës fillimisht foli drejtori i kësaj shkolle, Gani Rama, i cili tha se, ndonëse shkolla ishte themeluar pas Luftës së Dytë Botërore, vetëm në vitin shkollor 1963/64, për herë të parë në kuadër të kësaj shkolle, ishte hapur një paralele në gjuhën shqipe, ndërkaq vetëm pas mbajtjes së protestave është arritur angazhimi i mësimdhënësve shqiptarë.

Putini në Krime në pesëvjetorin e aneksimit

Moskë, 18 mars - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, qëndroi të hënën në Krime për të shënuar pesëvjetorin e ditës kur gadishulli ukrainas, sipas Moskës zyrtare, është bërë pjesë e Rusisë.
Ukraina dhe Perëndimi e kanë cilësuar këtë hap të Rusisë si "aneksim të paligjshëm" dhe kanë ndërmarrë nja varg sanksionesh kundër individëve dhe subjekteve ruse.
Putini përuroi dy stacione të reja të energjisë në qytetet Sevastopol dhe Simferopol. "Sot është bërë edhe një hap tjetër i rëndësishëm në përpjekjen tonë për të rritur sigurinë me energji në Gadishullin e Krimesë dhe në gjithë jugun e Federatës Ruse", tha Putini.
Dy stacionet e energjisë kanë qenë në qendër të një skandali ndërkombëtar, pasi kompania gjermane Siemens ka thënë se turbinat e saj janë instaluar atje pa dijeninë e saj.
Ky veprim është cilësuar si shkelje e sanksioneve të Bashkimit Evropian, që ndalojnë furnizimin me teknologji energjetike në Krime.
BE-ja i ka zgjeruar sanksionet ndaj kompanive dhe individëve rusë në vitin 2017, në përgjigje të transferimit të turbinave në Krime.
Ministria e Jashtme ruse e ka cilësuar vendimin si hap "jomiqësor dhe të pajustifikuar".
Më 18 mars të vitit 2014, Putini ka nënshkruar një traktat, i cili thotë se rajoni ukrainas i Krimesë është pjesë e Rusisë. Para këtij vendimi, forcat ruse kanë marrë kontrollin e Krimesë dhe kanë organizuar një referendum atje për bashkimin me Rusinë, i cili nuk është njohur nga komuniteti ndërkombëtar.



A do të marrin pjesë britanikët në zgjedhjet evropiane?

Zyrtarët në Bruksel janë të shqetësuar për ndikimin që mund të ketë vonesa e daljes së Britanisë nga blloku në zgjedhjet parlamentare evropiane të majit dhe kanë frikë se një valë euro-skeptikësh nga votuesit britanikë, nëse vendi merr pjesë në zgjedhje, do ta forcojnë rrymën e fortë populiste të pritshme në kontinent

Bruksel, 18 mars - Bashkimi Evropian duket se do të pajtohet me një vonesë për daljen e Britanisë nga blloku, por zyrtarët në Bruksel janë të shqetësuar për ndikimin që mund të ketë kjo në zgjedhjet parlamentare evropiane të majit. Ata kanë frikë se një valë euro-skeptikësh nga votuesit britanikë, nëse vendi merr pjesë në zgjedhje, do ta forcojnë rrymën e fortë populiste të pritshme në kontinent.
Disa zyrtarë të BE-së po eksplorojnë tani mënyra ligjore për të bllokuar pjesëmarrjen britanike me arsyetimin se Britania mund të mos jetë anëtare kur të përfundojë mandati parlamentar. Në vend të kësaj ata duan që deputetët e tanishëm britanikë në Parlamentin Evropian të vazhdojnë të mbajnë postin ose që qeveria britanike të emërojë deputetë të përkohshëm evropianë, të cilët të pasqyrojnë forcat aktuale të partive në Dhomën e Komunave të Britanisë.
Por edhe përkrahësit e Brexitit po eksplorojnë veprime ligjore për të bllokuar çdo përpjekje për të parandaluar pjesëmarrjen britanike. Kryesuesi i tyre Nigel Farage thotë se një parti e re e krijuar prej tij ka plane për të futur një listë të plotë kandidatësh. Avokatët që veprojnë për grupin e fushatës Brexit, "Leave Means Leave", janë në bisedime me qeverinë.
John Longworth, kryetar i grupit, i cili favorizon një shkëputje edhe pa marrëveshje, tha se "ne jemi të vendosur të sfidojmë qeverinë dhe BE-në nëse ata përpiqen të mohojnë të drejtën demokratike të popullit të Mbretërisë së Bashkuar për t'u përfaqësuar në Parlamentin e BE-së".
Të enjten kryeministrja Theresa May pritet t'i takojë udhëheqësit evropianë në Bruksel, ku ajo do të kërkojë shtyrjen e Brexit-it pas refuzimit nga Parlamenti të marrëveshjes së saj për tërheqjen nga BE-ja, e cila u miratua nga Brukseli nëntorin e kaluar. Dhoma e Komuneve gjithashtu ka bllokuar Britaninë për të dalë nga BE-ja pa një marrëveshje.
Nuk është e qartë nëse ajo do të kërkojë një zgjatje të shkurtër tremujore, duke shpresuar ende për të siguruar miratimin parlamentar për marrëveshjen e saj, që është hedhur poshtë dy herë deri tani, apo një shtyrje më të gjatë. Franca dhe Gjermania favorizojnë një vazhdim më të gjatë prej 21 muajsh.
Kryeministrja May i ka paralajmëruar ligjvënësit që e kundërshtojnë marrëveshjen e saj, të cilën ajo mund ta hedhë përsëri në votim të martën, se do të duhet të marrin pjesë në zgjedhjet evropiane, nëse votojnë përsëri kundër marrëveshjes së saj të divorcit me BE-në dhe dalja vonohet përtej qershorit 30, pak para se deputetët e rinj të marrin vendet e tyre.
Kaosi Brexit po bëhet gjithnjë e më shumë një makth ligjor ashtu si edhe politik për Britaninë dhe BE-në. Një opinion ligjor i ofruar për ambasadorët e BE-së javën e kaluar, paralajmëroi se Brukseli do të ishte i detyruar sipas rregullave të bllokut të përfundonte anëtarësimin britanik në BE më 1 korrik, nëse Britania nuk do të marrë pjesë në zgjedhjet e 23 majit.
"Asnjë zgjatje nuk duhet të jepet përtej 1 korrikut nëse nuk zhvillohen zgjedhjet e Parlamentit Evropian në datën e caktuar", thuhet në opinionin ligjor.
Për zyrtarët e BE-së dhe politikanët e qendrës evropiane, të cilët gjithmonë kishin shpresuar se Brexit nuk do të ndodhte, perspektiva e pjesëmarrjes britanike në zgjedhjet e majit mund të ishte me pasoja. "Mund të shohim shumë më tepër njerëz si Farage të zgjedhur në parlament dhe kjo rrezikon rrënjosjen e populistëve dhe minimin e përpjekjeve për të rivendosur stabilitetin dhe parashikueshmërinë përballë rritjes së nacionalizmit", tha një zyrtar i lartë i BE-së.
Të hënën ministri britanik i Tregtisë, Liam Fox, paralajmëroi konservatorët në pushtet se ata duhet të jenë gati të marrin pjesë në zgjedhjet evropiane në maj.
Zgjedhjet parlamentare evropiane të këtij viti ka të ngjarë të jenë më të rëndësishmet që blloku ka mbajtur ndonjëherë. Dy vizione kontradiktore të Evropës janë përpara votuesve me centristët e kryesuar nga presidenti francez Emmanuel Macron dhe populistët nacionalistë të mbështetur nga Matteo Salvini i Italisë. Populistët janë drejtuar për këshilla tek ish-ndihmësi i Donald Trumpit, Steve Bannon.
Macron e ka pozicionuar veten si antidotë për "demokracitë joliberale" të Evropës Qendrore dhe mbrojtësit e Bashkimit Evropian të kërcënuar nga nacionalistët populistë si Salvini. Udhëheqësi francez dëshiron të reformojë dhe të ringjallë bllokun duke thelluar integrimin politik dhe ekonomik të Evropës.
Salvini 44-vjeçar dëshiron të kundërtën, jo vetëm një frenim në integrimin e mëtejshëm, por edhe një grupim më të lirshëm të shteteve me më pak detyrime nga traktatet e Brukselit dhe të BE-së.
Hulumtuesit parashikojnë se euro-skeptikët do të kapin një të tretën e 705 vendeve të Parlamentit Evropian.

Masakër në Holandë, tre të vrarë dhe nëntë të plagosur

Hagë, 18 mars - Tre veta u vranë dhe të paktën nëntë të tjerë u plagosën nga të shtënat në një tramvaj në qytetin Utrecht të Holandës, tha prefekti i këtij qyteti në një deklaratë për stacionin holandez NOS.
Policia tha se është vënë në kërkim të një 37-vjeçi më origjinë turke që u identifikua si Gokmen Tanis, në lidhje më sulmin.
Autoritetet thanë se sulmi "mund të ketë motive terroriste". Kryeministri Mark Rutte tha se është thellësisht i brengosur, ndërsa Radioja holandeze tha se janë shtuar masat e sigurisë përreth selisë së qeverisë në Hagë.
Bashkërenduesi kombëtar për luftën kundër terrorizimit tha se është shtuar shkalla e gatishmërisë derisa sulmuesi është ende në arrati.

BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.

E rrallë

Vendoset rekordi, gatuhet tiramisuja më e gjatë në botë

Në qytetin e Milanos në Itali është vendosur rekordi për tiramisunë më të gjatë në botë. Ëmbëlsira 273.5 metra ka fituar titullin në rekordet Gines si tiramisuja më e gjatë e gatuar ndonjëherë. Ëmbëlsira u realizua mbi 80 tavolina.

FOTO E DITES

Një ari polar dhe e ëma janë fotografuar në kopshtin zoologjik Tierpark në Berlin. /AFP/

E jashtëzakonshme

Gruaja lind gjashtënjakë në më pak se 10 minuta

Një grua në Hjuston, Texas, ka lindur gjashtënjakë, duke mposhtur shanset për të qenë një në 4.7 miliard. Thelma Chiaka lindi dy herë nga dy djem dhe më pas vajzat binjake në mëngjesin e së premtes në Spitalin e Grave në Texas. Të gjashtë fëmijët lindën midis orës 04.50 dhe 04.59 me pesha që variojnë nga një kilogram deri në dy kilogramë. Sipas të dhënave nga spitali, secili nga fëmijët është në gjendje të qëndrueshme dhe do të vazhdojë të mbikëqyret në njësinë e avancuar të kujdesit intensiv neonatal.

BARSOLETA E DITËS

Arsimtari i historisë, i nervozuar me një nxënës që nuk rri qetë, i bërtet:
- A e di ti se Hashim Thaçi në moshën tënde ka qenë nxënës i shkëlqyeshëm?
Nxënësi ia kthen:
- Po a e dini ju se në moshën tuaj ai është bërë kryeministër?

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 14:00

"SHEEP AND WOLVES" 3D



I Animuar/Aventure/Komedi; 1 ore 25 min

Rolet: Graham Halstead, Vladimir Chuprikov
Regjia: Vladimir Nikolaev

Vetem gjate vikendit në ora 16:00

"ALITA: Battle Angel" 3D

Aksion/Aventure/Romanse; 2 ore 02 min

Rolet: Rosa Salazar, Christoph Waltz, Jennifer Connelly, Mahershala Ali, Ed Skrein, Jackie Earle Haley, Keean Johnson, etj.
Regjia: Robert Rodriguez

Në ora 18:00

"BERLIN, I LOVE YOU"

Dramë/Romansë; 2 ore

Rolet: Keira Knightley, Helen Mirren, Luke Wilson, Mickey Rourke, Jenna Dewan
Regjia: Dianna Agron, Peter Chelsom, Claus Clausen

Në ora 20:00 dhe 22:00

""SERENITY"

Dramë/Triller; 1 orë 46 min

Rolet: Matthew McConaughey, Anne Hathaway, Diane Lane, Jason Clarke, Djimon Hounsou, Jeremy Strong, etj.

Regjia: Steven Knight

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Edhe pse sot është ditë e zhurmshme ju ndiheni shumë plogësht. Nuk keni dëshirë fare t'i përkushtoheni impenjimeve tuaja.



DEMI
Një çështje e rëndësishme biznesi sot do t'ju mbajë nën tension gjatë gjithë ditës. Nuk do t'i jepni dot zgjidhje të shpejtë.

BINJAKËT
Edhe pse sot jeni disi ëndërrimtarë përsëri nuk e keni humbur kontaktin me realitetin. Qëndroni me këmbë në tokë.

GAFORRJA
Momente kreativiteti sot për ju dhe qëndrim në ambiente artistike ku doni të mësoni gjëra të reja.

LUANI
Sot nuk jeni të kënaqur nga ana sentimentale. Ndjenjat që provoni për dike nuk kompensohen në mënyre reciproke dhe kjo gjë ju mërzit.

VIRGJERESHA
Dita juaj sot nuk ka vetëm ngjyrat e entuziazmit që ju shoqëron gjithmonë, por edhe ato të pasionit. Jeni shumë sharmantë.

PESHORJA
Tensionet dhe keqkuptimet e të shkuarës dalin më në pah gjatë ditës së sotme. Debate të ashpra priten gjatë pjesës së dytë të ditës.

AKREPI
Sot ndiheni romantikë dhe doni të qëndroni vetëm pranë njeriut të zemrës. Kushtet e ditës nuk ia u lejojnë këtë gjë për shkak të angazhimeve.

SHIGJETARI
Më në fund keni filluar të lëvizni në fushën e financave sepse po shikoni që të tjerët kanë marrë përfitimet e investimeve tuaja.

BRICJAPI
Miqtë do t'ju lenë hapësira veprimi gjatë ditës së sotme sepse e dinë që ju keni qejf të bëheni protagonist në rrethin shoqëror.

UJORI
Mungesa e anës financiare sot do t'ia u vështirësojë punët por ju nuk i shtrini këmbët asnjëherë më tepër se jorgani kështu që do të menaxhoni ato që keni.

PESHQIT
Fokusohuni tek financat sot sepse çdo gjë tjetër do të shkojë qetë gjatë ditës. Edhe pse jeni të shqetësuar për një problem, do t'i jepni zgjidhje.

Jennifer Lopezi vë në pah unazën gjigante të fejesës

Jennifer Lopezi është fotografuar krah për krah me të fejuarin e saj Alex Rodriguez derisa arritën në një restorant për darkë, në qytetin e Nju Jorkut. 49-vjeçarja vuri në pah unazën e saj gjigante të fejesës, ndërsa ishte e veshur me xhinse dhe një pallto të gjatë. Ndërkaq Alex kishte të veshur një pallto gri për këtë natë romantike.

Jade Thirlwall duket e lumtur me të dashurin Jed Elliott

Këngëtarja e grupit Little Mix, Jade Thirlwall, është në lidhje me Jed Elliott. Çifti shihet se janë të lumtur me njëri-tjetrin. Sipas "Daily Mail", çifti të dielën doli për darkë në "Covent Garden" në Londër.

Rita Ora do të këndojë në Tajvan

Këngëtarja me prejardhje nga Prishtina, Rita Ora, brenda një kohe shumë të shkurtër ka publikuar dy këngë të reja. Sipas "Daily Mail", Rita Ora do të performojë të shtunën në skenën Taipei në Tajvan të Kinës, në kuadër të turit të saj Phoenix 2019. Përpara kësaj performance ajo është veshur në të kuqe, e cila i rrinë shumë mirë.

Pse u përpoq të vetëvritej Paris Jacksoni?

Paris Jacksoni është duke u përmirësuar pas shtrimit në spital. Pas raportimeve të fundit, ajo u përpoq të bënte vetëvrasje të shtunën, dhe tani një burim i afërt me vajzën 20-vjeçare të Michael Jackonit po sqaron çfarë ndodhi. "Parisi pati një incident që kërkonte trajtim mjekësor", ka thënë burimi për "People". "Ajo aktualisht është në shtëpi dhe po bën më mirë", ka thënë ky burim. Parisi më pas ka shkruar në "Twitter" dhe hodhi poshtë të gjitha raportimet për vetëvrasje duke thënë se ishin gënjeshtra.

PROGNOZA SPORTIVE	PISTOIESE - PRO PIACENZA	2	DUNDEE UNITED - ROSS COUNTY	X	BARNET - HARROGATE T.	2

Challandesi 'harron' suksesin në Ligën e Kombeve: Gjithçka fillon nga zero

Trajneri i Kosovës në futboll, Bernard Challandes, duket se e ka 'harruar' shumë shpejt suksesin historik në Ligën e Kombeve, pasi para ndeshjeve miqësore ndaj Danimarkës dhe kualifikueses ndaj Bullgarisë, ka thënë se gjithçka për "Dardanët" fillon nga zero. "Nuk luajmë më kundër rivalëve të Ligës D, por ndaj ekipeve nga Liga A dhe B, që nënkupton se janë ekipe të kategorisë krejt tjetër. Kjo është një tjetër garë, një tjetër jetë për skuadrën tonë. Për mua është një fazë interesante për ta parë zhvillimin e ekipit tonë dhe për ta përsëritur edhe një herë. Vitin e kaluar kemi pasur sukses, por tani gjithçka fillojmë nga zero", ka thënë Challandes

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 18 MARS - Përzgjedhësi i Kosovës në futboll, Bernard Challandes, të hënën në konferencë për medie ka vlerësuar se për "Dardanët" tash fillon një cikël i ri, pas suksesit historik në Ligën e Kombeve. "Është kënaqësi që të jem këtu dhe që do të fillojmë një cikël të ri. Për mua është një sfidë mjaft e vështirë, pasi tashmë kemi kaluar në një nivel tjetër. Kemi pasur sukses në Ligën e Kombeve dhe në miqësore, por e dimë saktësisht çfarë na pret. Nuk luajmë më kundër rivalëve të Ligës D, por ndaj ekipeve nga Liga A dhe B, që nënkupton se janë ekipe të kategorisë krejt tjetër. Kjo është një tjetër garë, një tjetër jetë për skuadrën tonë. Për mua është një fazë interesante për ta parë zhvillimin e ekipit tonë dhe për ta përsëritur edhe një herë. Vitin e kaluar kemi pasur sukses, por tani gjithçka fillojmë nga zero", ka thënë Challandes.

Tekniku zviceran, duke folur për ndeshjen miqësore ndaj Danimarkës, e cila zhvillohet më 21 mars në stadiumin "Fadil Vokrri", ka thënë se dëshiron të provojë tri gjëra ndaj një kundërshtari që është në dhjetëshen më të mirë të FIFA-s. "Për ne është mjaft e mirë të luajmë me një ekip të tillë. Është e rëndësishme që i luajmë dy ndeshjet këtu. Tri qëllime ndaj Danimarkës janë: se si mund të mbrohemi ndaj një ekipi të fuqishëm ofansiv. Synimi i dytë është se si mund ta mbajmë dhe qarkullojmë topin. Synimi i tretë është si të krijojmë raste dhe të ndërtojmë aksione. Megjithatë, fokusi do të jetë te Bullgaria", ka shtuar ai.

Në dy ndeshjet e marsit Kosova nuk mund të llogaritë në shërbimet e mesfushorit të Lazios, Valon Berisha. Ndaj Danimarkës mungon edhe mesfushori tjetër, Hekuran Kryeziu, i cili pritet të rikthehet për ndeshjen e parë kualifikuese ndaj Bullgarisë. Trajneri Challandes beson se Bersant Celina do të jetë një zëvendësues ideal për Valon Berishën. "Valoni ka një muaj që nuk ka luajtur dhe përkundër dëshirës së madhe që ka, është e pamundur të jetë me ne. Edhe klubi nuk e ka lejuar grumbullimin në përfaqësuese duke e parë situatën fizike të tij. Ne duhet të fokusohemi te lojtarët e tjerë dhe aty është Bersant Celina, i cili ka pasur paraqitje të mira me Swansean dhe mund ta marrë atë pozicion pa problem. Ndërsa sa i përket Hekuranit, jemi në kontakt dhe në pritje të testeve mjekësore. Ndaj Danimarkës mendoj se është shumë shpejt, por besoj se do të jetë në ndeshjen e dytë ndaj Bullgarisë", ka deklaruar ai.

Gjatë javës së fundit është folur shumë për lojtarët që do të përfaqësojnë Kosovën në të ardhmen, përfshirë emrat si Florent Hadergjonaj dhe Meritan Shabani. Lidhur me këtë temë trajneri zviceran ka konfirmuar se ekzistojnë kontaktet me këta dhe shumë lojtarë të tjerë. "Kam punuar shumë gjatë kësaj periudhe dhe kam bërë kontakte me disa lojtarë që kanë potencial për t'iu bashkuar Kosovës në të ardhmen, por duhet të kuptojmë se nuk është e lehtë edhe për ta që ta marrin vendimin, se ndikon edhe në tërë karrierën e tyre. Kemi pasur kontakt me Hadërgjonajn, Rexhbecajn, Shabanin, Muslijajn si dhe Vallcin", ka deklaruar Challandes. Në fund numri një i përfaqësues foli edhe për lojtarët e Superligës, duke konfirmuar se gjasat gjithmonë ekzistojnë dhe se dera është e hapur por, sipas tij, për t'u ftuar në përfaqësuese një lojtar duhet të ketë kualitet e jo të ftohet vetëm për t'i përmbushur ambiciet e dikujt apo të motivohen të tjerët.

SHKURT

Karahoda, tri javë jashtë fushës

Sulmuesi Fatih Karahoda është lënduar në ndeshjen ndaj Dritës. Ai pritet t'i mungojë skuadrës së Lirisë deri në tri javë si pasojë e lëndimit të pësuar në fytyrë. "Pas ekzaminimit mjekësor Fatih Karahoda të martën në QKUK në Prishtinë do t'i nënshtrohet një intervenimi kirurgjik në mollëzën e fytyrës dhe pritet të jetë larg fushës së blertë për rreth tri javë. KF Liria i dëshiron Karahodës shëndet dhe kthim sa më të shpejtë në fushë", thuhet në njoftimin e skuadrës nga Prizreni.

Kosova fiton dy medalje në Lojërat Olimpike Speciale Botërore

Një e artë dhe një e bronztë është bilanci i medaljeve të fituara të Kosovës në Lojërat Olimpike Speciale Botërore që po mbahen në Abu Dhabi të Emirateve të Bashkuara Arabe, prej 14 deri më 21 mars. Medaljen e artë e ka fituar Sheqi Vllasaliu në atletikë, disiplina 200 metra, ndërsa në të njëjtën garë, të bronztën e fitoi Ibish Zogaj. Kosova po përfaqësohet në këtë Olimpiadë me katër garues, të gjithë nga sporti i atletikës. Atletët e tjerë janë Anila Kastrati dhe Qëndresa Dili. Olimpiada Speciale e Kosovës vepron si Organizatë Joqeveritare në vendin tonë që nga viti 2007.

Mavraj e përjeton mungesën në kombëtare

Kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Mërgim Mavraj, është duke e vuajtur shumë pezullimin me tri ndeshje moslojë pas kartonit të kuq të marrë në takimin ndaj Skocisë. 32-vjeçari ka publikuar së fundmi në rrjetin social "Instagram" një foto me fanellën e ekipi kombëtar, teksa shkruan: "Sa ditë e mërzitshme mos me i vesh këto ngjyra në ditën e grumbullimit të Kombëtares. Zoti ju ndihmoftë, çuna!". Kujtojmë që Mavraj numëron plot 40 paraqitje me Shqipërinë teksa ka arritur ta gjejë edhe tri herë rrugën e rrjetës.

Avdijaj largohet nga Willem II

Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Donis Avdijaj, është larguar edhe zyrtarisht nga skuadra holandeze, Willem II. Lajmi është bërë me dije të hënën në faqen zyrtare të klubit. Në njoftimin e klubit holandez është bërë me dije se shkëputja e menjëhershme e kontratës është bërë me marrëveshje të dyanshme. 22-vjeçari te Willem II u transferua gjatë verës së vitit të kaluar nga Schalke, por u largua për shkak të problemeve disiplinore dhe fizike. Së fundi është raportuar se skuadra zvicerane Luzern ka shprehur interesim për ta transferuar sulmuesin kosovar.

Chelsea refuzon ofertën e Realit për Hazardin

LONDËR, 18 MARS - Real Madridi ka ofruar 82 milionë euro për Eden Hazardin, mirëpo Chelsea e ka refuzuar ofertën e klubit spanjoll. "The Sun" bëri me dije se presidenti i klubit spanjoll, Florentino Perez, kishte dorëzuar ofertën e lartpërmendur te klubi londinez, mirëpo të hënën media belge "HLN" ka bërë me dije se Chelsea e ka refuzuar ofertën. Raportimet e reja shpjegojnë se në Londër po presin një ofertë që sillet nga 100-120 milionë euro për sulmuesin belg. Hazardi ka kontratë me Chelsean deri në qershor të vitit 2020 dhe nëse nuk largohet në afatin kalimtar të verës, atëherë sezonin e ardhshëm ai mund të bashkohet me Real Madridin si lojtar i lirë.

Sadiku: Turqinë e respektojmë, dua të asistoj për Grezdën

TIRANË, 18 MARS - Armando Sadiku mungon prej kohësh në kombëtare për shkak të një dëmtimi në gju që pësoi në verë me Levanten. Sulmuesi ka nisur të luajë, por në Zvicër. Ai u transferua te Lugano dhe kërkon ta kapë formën maksimale. Në konferencë për medie të organizuar nga Federata Shqiptare e Futbollit para ndeshjes me Turqinë foli për gjendjen fizike si dhe për kundërshtarin. "Pas shtatë muajsh kthehem të luaj, jam i lumtur dhe me energji. Mezi pres të luaj dhe të shënoj. Jam mirë në aspektin fizik. Kam luajtur shtatë ndeshje atje, tre si titullar. Për momentin jam shumë mirë. Turqia ka lojtarë cilësorë dhe me emra. I respektojmë. Nuk i nënvlerësojmë se i mundëm në miqësore. Do ta japim maksimumin që të përsëritim atë ndeshje", ka thënë Sadiku. "Uroj të marrim gjashtë pikë në dy ndeshje. Edhe katër janë 'ok". Kemi vënë bast me trajnerin, po morëm 6, do të na dhurojë diçka. Duhet të jemi bashkë të gjithë si grup, vetëm kështu mund t'i përsërisim rezultatet e shkuara. Grupi është dhe mund t'ia dalim. Atmosfera është e mirë. Edhe afrimet duhet t'i ndihmojmë të futen në ekip. Për momentin atmosfera është e mirë. Unë e di që është grumbulluar. Do të isha më i gëzuar po ta asistoja unë për Erosin. Gjithmonë më ka thënë se do të jap top dhe do të shënosh. Kështu që do të jem shumë i lumtur po asistova. Grupi është i vështirë, Me Islandën dhe Turqinë luhet kualifikimi. Uroj të kemi edhe fat. Nëse bëhemi grup, që të ndihmojmë njëri-tjetrin, do t'ia dalim. Kam besim te vetja dhe tek ekipi", ka deklaruar Sadiku, i cili bëri me dije se nuk e njeh Durmishajn.

Grezda: Në dy ndeshje duam 6 pikë

Eros Grezda është gati për dy ndeshjet e radhës, kurse shpreson se Shqipëria do ta marrë maksimumin e pikëve. "Pata një periudhë shumë të vështirë në dy muajt e fundit, u ktheva pardje dhe ndihem shumë mirë. Gjatë kohës që kam qenë i lënduar kam punuar. Kemi lojtarë cilësorë, të cilët janë në formë. Do të bëjmë maksimumin, trajneri do t'i bëjë zgjidhjet e veta. Duhet të shkojmë për gjashtë pikë, pasi luajmë me Turqinë në shtëpi dhe me një ekip me të vogël se vetja. Në Evropianin e fundit kemi bërë shumë mirë, dhe këtë herë do të bëjmë të njëjtën gjë. Kemi një grup shumë të mirë. Duam ta bëjmë gjithë kombin krenar", ka thënë Grezda.

Houstoni mposhti Minnesotan

HOUSTON, 18 MARS - Houston Rocketsi ka triumfuar kundër Minnesota Timberwolvesit me rezultatin 117-102. Chris Pauli shënoi 25 pikë dhe asistoi 10 herë. Po kaq herë shërbeu edhe James Hardeni për shokët e skuadrës, ndërkohë që realizoi vetëm 2 pikë, sikurse edhe Clint Capela. Ky i fundit spikati edhe me 13 topat e rikuperuar. Karl-Anthony Towns ishte më i miri për mysafirët, teksa shënoi 22 pikë, asistoi 6 herë dhe rikuperoi 10 topa. Fitore e vlefshme për Los Angeles Clippersin, që kaloi me sukses Brooklyn Netsin me shifrat 119-116. D'Angelo Russell (32 pikë, 5 asistime, 10 rikuperime) nuk ia doli ta përballonte dot forcën e grupit të Clippersit.

REZULTATET

Orlando Magic - Atlanta Hawks	101-91
Sacramento Kings - Chicago Bulls	129-102
Houston Rocket - Minnesota Ti.	117-102
Los Angeles Clippers - Brooklyn Nets	119-116

Lou Williams (25 pikë), Danilo Gallinari (20 pikë, 5 asistime, 11 rikuperime) dhe Montrezl Harrell (20 pikë, 1 asistim, 10 rikuperime) ishin ata që nderuan vendësit për arritjen e rezultatit pozitiv. Orlando Magic kaloi me sukses Atlanta Hawksin. Kjo ndeshje përfundoi 101-91 dhe ishte Nikola Vuçeviç njeriu i ndeshjes, pasi shënoi 27 pikë, dha 3 asistime e rikuperoi 20 topa. Fitore edhe për Sacramento Kingsin, që mposhtu Chicago Bullsin me rezultatin 129-102.

SHKURT

UEFA nis hetimet ndaj Ronaldos për festimin provokues

UEFA ka nisur hetimet ndaj festimit provokues të Cristiano Ronaldos pasi që ai udhëhoqi Juventusin drejt fitores 3-0 ndaj Atletico Madridit në mesjavën e kaluar, duke e kualifikuar skuadrën në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. UEFA të hënën ka njoftuar se Ronaldo përballet me sjellje të pahijshme, pasi ai kishte përsëritur festimin që kishte bërë trajneri i Atleticos, Diego Simeone, në ndeshjen e parë mes dy skuadrave në Madrid, të cilën skuadra madrilene e kishte fituar me shifrat 2-0. Komisioni i Kontrollit, Etikës dhe Disiplinës i UEFA-s do të marrë vendim për rastin të enjten. Simeone për festimin e tij ishte gjobitur me 20 mijë funte, mirëpo nuk u suspendua.

Messi: Nuk më kujtohet të jem duartrokitur nga tifozët rivalë

Lionel Messi ishte fantastik në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin e Real Betisit dhe tifozët vendës nuk mund të bënin asgjë përveçse ta duartrokisnin. Superylli i Barcelonës shënoi tregola, kurse Barcelona fitoi me rezultat 4-1. "Nuk më kujtohet të jem duartrokitur nga tifozët rivalë për një gol në të kaluarën", ka thënë Messi.

Dortmundi, favorit për transferimin e Brandtit

Ylli i Bayer Leverkusenit, Julian Brandt, ende nuk ka dhënë sinjale për ta rinovuar kontratën me skuadrën e Leverkusenit. Klauzola prej vetëm 25 milionë eurosh në kontratën me klubin, dhe potenciali i madh si futbollist, ka bërë që shumë klube si Atletico Madridi, Borussia Dortmundi dhe Real Madridi të shfaqin interesim për transferimin e tij. "Kicker" raporton se favorit për transferimin e mesfushorit gjerman është skuadra e Dortmundit.

Thiemi mposhti Federerin në finalen e Indian Wellsit

Tenisti austriak Dominic Thiem ka triumfuar në turneun e parë Masters të vitit 2019, atë të Indian Wellsit, duke mundur 2-1 në finale (3-6, 6-3, 7-5) zviceranin Roger Federer. Falë këtij suksesi Thiemi ngjitet në vendin e katërt të renditjes botërore, ndërsa Federeri ndodhet një vend pas tij. Ndeshja nisi mirë për Federerin, që dominoi në setin e parë, ku u shkëput që në fillim dhe fitoi 6-3. Por shpejt u rikuperua Thiem, që përmbys lojën në setin e dytë, duke ngritur ndjeshëm nivelin dhe fitoi 6-3. Loja bëhet mjaft e bukur në setin e tretë, ku loja është e barabartë deri në shifrat 5-5. Më pas Thiemi fiton një "game" me topat e Federerit, duke triumfuar 7-5 dhe krejt ndeshjen 2-1. Në përballjet direkte, Thiemi udhëheq 3-2 ndaj Federerit, duke u ngjitur për herë të parë në karrierë në vendin e katërt. Kjo është hera e parë për austriakun që fiton në një turne Masters.

Barça sërish interesohet për Griezmannin

Eliminimi i Atletico Madridit nga Liga e Kampionëve do të ketë pasoja në aspektin sportiv te klubi, e do ta prekë edhe yllin e kësaj skuadre, Antoine Griezmann. Sipas së përditshmes "L'Equipe", Barcelona duket se ka vendosur të bëjë një tjetër tentativë për blerjen e sulmuesit francez, i cili duket se këtë radhë po mendon seriozisht të ardhmen e tij në aspektin profesional. "L'Equipe" zbulon edhe një të dhënë tjetër, që mund të rezultojë thelbësore në këtë histori. Klauzola e zgjidhjes së kontratës, që Griezmann rinovoi në muajin maj, është 200 milionë euro, por me një përjashtim: deri në qershor ajo është 120 milionë euro, një shifër kjo më se e përballueshme për një klub si Barcelona. E përditshmja prestigjioze sportive franceze thekson se drejtuesit e klubit katalanas kanë hyrë tashmë në kontakte me përfaqësuesit e futbollistit, duke ofruar një kontratë për lojtarin deri në vitin 2024, me pagë 16 milionë euro në sezon, që do ta bënte atë lojtarin e dytë më të paguar te Barcelona pas Messit.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova – University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit

Nr.Ref. 232/19, datë 15.03.2019.

Në bazë të nenit 13 pika 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Ankesës nr. 1022 të datës 13.03.2019 dhe Kërkesës nr. 422 të datës 14.03.2019, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, nxori këtë:

V E N D I M
Për Anulim të pjesërishëm të Konkursit publik,

I. Konkursi publik nr. 201, datë 11.02.2019, për **Mjekë Specialistë të lëmive të ndryshme në QKUK (13 pozita) dhe Logoped (2 pozita) anulohet** pjesërisht vetem pozita e dy Logopedëve në QKUK. Me pozitat tjera vazhdohet si në rekomandimet e më hershme.

II. Obligohet Sektori i Personelit për zbatimin e këtij Vendimi;
III. Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni Përzgjedhës me Vendimin nr. 201/4 dt. 26.02.2019, ka mbajtë Testin me shkrim më datë 11.03.2019 për kandidatët Logoped. Publikimi i testit me shkrim është bërë të njejtën ditë 11.03.2019. Por, më Ankesën nr. 1022 datë 13.03.2019, drejtuar Instancave më të larta të QKUK/SHSKUK, kandidatet e pa kënaqur me rezultatet e publikuara me shkrim për Logoped, shprehin pakënaqësi. Më Kërkesën nr. 422 datë 14.03.2019, Kryesuesi i Komisionit Përzgjedhës kërkon nga Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së që këto dy pozita të Logopedëve sipas konkursit publik të anulohen në tërësi për arsye të vërejtjeve të kandidatëve për Logoped dhe pas modifikimit të konkursit tjetër të publikohet në mjetet e informimit sa më parë që të jetë i mundur.

Prandaj, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, në bazë të kompetencave, konform ligjit në fuqi dhe Ankesës së kandidatëve dhe Kërkesës në fjalë, lejon anulimin e konkursit për pozitën e Logopedit dhe i njejti të modifikohet dhe të përseritet ne mjetet e informimit konform bazës ligjore.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VENDIMI T'I DORËZOHET
- ✓ Zyrës së personelit,
- ✓ Një mediumit informativ.
- ✓ Arkivit.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Agim Ramadani, Nr.23, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: ++381 38 500 400, Faks: ++ 381 38 248 076, E-mail: info@pak-ks.org, web: www.pak-ks.org

NJOFTIM PUBLIK

PËR TRANSFROMIMIN [PRIVATIZIMIN] E PRONËS SHOQËRORE
PËRMES NEGOCIMIT TË DREJTË PËR DREJTË

Njoftohen palët e interesuara [subjekt fizik dhe/ose juridik] se Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me Vendimin Nr. BD 112/22, datë 30 Janar 2019, ka miratuar *Rregulloren për shitjen e aseteve të caktuara të ndërmarrjeve shoqërore me negocim direkt*. Rregullorja në rastin konkret përbën akt nënligjor të Agjencisë, e cila ka të bëje me shqyrtimin e aseteve me natyrë specifike të cilat evidentohen në emër të ndërmarrjeve shoqërore përderisa të njëjtat, në kuptim të Ligjit Për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përfshihen nën juridiksionin e kësaj Agjencie.

Bordi i Drejtorëve mori një vendim të tillë, duke pasur parasysh faktin se ndaj ndërmarrjeve shoqërore dhe/ose aseteve të tyre, vazhdojnë të evidentohen një numër i konsiderueshëm i pretendimeve pronësore me natyrë potencialisht kontestuese, përderisa konstatimi i vlefshmërisë së këtyre pretendimeve kërkon një masë të konsiderueshme të kohës dhe punës profesionale.

Duke ju referuar nenit 15 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Bordi i Drejtorëve ka kompetencë që në harmoni me legjislacionin në fuqi, ti shqyrtoj të gjitha ato kërkesa dhe/ose pretendime me natyrë specifike, të cilat kualifikohen si të tilla kurse paraqesin pengesë në procesin e transformimit pronësor.

Agjencia inkurajon subjektet e ndryshëm (fizik dhe/ose juridik), se kanë të drejtë ta iniciojnë procesin e negocimit direkt me Agjencinë, nëse paraprakisht konstatohet se pretendimet e tyre kualifikohen si raste specifike (baza juridike e pretendimeve, natyra, komplekse e çështjes, origjina e pretendimeve e tjera, sipas Rregullores së cituar si më sipër) dhe ju referohen pasurive të ndonjë ndërmarrje shoqërore e cila sipas legjislacionit në fuqi, bije nën administrimin e këtij Institucioni.

Në pajtim me legjislacionin në fuqi, inicimi i procedurës administrative për çështjet e shpjeguara si më sipër, bëhet sipas detyrës zyrtare të Agjencisë në emër dhe për llogari të ndërmarrjeve shoqërore dhe me kërkesën e palëve të interesuara, të cilat në Zyrat Rajonale dhe/ose në faqen zyrtare të Agjencisë mund të pajisen me Formularin e kërkesës për inicimin e procedurës i cili përmban elementet qenësore të kërkesës dhe disa nga udhëzimet parimore.

Për mbështetje, këshilla dhe shpjegime eventuale qytetarët kanë të drejtë ti drejtohen Zyrave Rajonale dhe/ose Zyrës Qendrore të Agjencisë, kurse kërkesa e kompletuar dorëzohet drejtë për drejtë në Zyrën Rajonale në territorin e së cilës gjendet patundshmëria.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinicki Centar Kosova – University Clinical Center of Kosovo
Sektori i Personelit

Ref. Br. 232/19, data 15.03.2019.

Na osnovu člana 13, stav 3 Statuta Službe Bolnice i Kliničke Universitetske Kosova, član 6 tačka 5.1, Administrativno uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o Regulisanju Procedura Javnog Konkursa i Zahtevu br. 422 od 14.03.2019, Generalni Direktor UBKSK je izdao:

O D L U K A
Za delimično poništenje javnog konkursa,

I.. Javni konkurs br. 201, od 11.02.2019, za Specijaliste Lekara u različitim oblastima UKCK-a (13 pozicija) i **Logoped (2 pozicije)** delimično je poništio samo poziciju dva Logopeda u UKCK-u. Sa drugim pozicijama se nastavlja kao u ranijim preporukama.
II. Sektor za osoblje je obavezan da sprovede ovu Odluku;
III. Odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

O b r a z l o ž e n j e

Komisija za izbor sa Odlukom br. 201/4 dt. 26.02.2019, održao je pismeni test 11. marta 2019. godine za kandidate Logopeda. Pisani test je objavljen istog dana 11.03.2019. Ali sa Žalbom br. 1022, od 13. marta 2019. godine, upućene najvišim instancama UKCK / UBKSK, kandidati nezadovoljni objavljenim rezultatima napisanim za Logoped, izrazili su nezadovoljstvo. Na zahtev br. 422, od 14.03.2019. Godine, Predsednik Selekcione komisije zahteva od Generalnog Direktora UBKSK-a da ove dve pozicije Logopeda pod javnim konkursom budu u potpunosti otkazane zbog najave kandidata za Logoped i nakon objavljivanja izmena drugog konkursa na način što je pre moguće.

Prema tome, Generalni Direktor UBKSK-a, u skladu sa važećim zakonom i žalbom kandidata i predmetnim podneskom, dozvoljava poništenje konkursa za položaj Logopeda i isto tako da se izmeni i ponovi u načinu informisanja u skladu sa pravnom osnovom.

Kao što je već navedeno, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

ODLUKA KOJI SE PODNOSI
* Kancelarija za kadrove,
* Informacioni medij.
* Arhiva.

Generalni Direktor UBKSK.

Dr. Basri Sejdiu

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Ul. Agim Ramadani, br.23, 10000 Priština, Kosovo
Tel: ++381 38 500 400, Faks: ++ 381 38 248 076, E-mail: info@pak-ks.org, web: www.pak-ks.org

JAVNO SAOPŠTENJE

ZA TRANSFORMACIJU [PRIVATIZACIJU] DRUŠTVENE SVOJINE
DIREKTNIM PREGOVORIMA

Obaveštavaju se zainteresovane stranke [fizička i/ili pravna lica] da je Odbor Direktora Kosovske Agencije za Privatizaciju 30 januar 2019 donelo odluku br. 112/22 i time odobrilo *Uredbu za prodaju određene imovine društvenih preduzeća direktnim pregovorima*. U konkretnom slučaju, uredba predstavlja podzakonski akt Agencije, za razmatranje imovine specifične prirode koje se vode na ime društvenih preduzeća, dok se iste na osnovu Zakona za Kosovsku Agenciju za Privatizaciju spadaju pod nadležnost ove Agencije.

Odbor direktora je donelo dotičnu odluku imajući u vidu činjenicu da za društvena preduzeća i/ili njihove imovine nastavlja evidentiranje značajnog broja vlasničkih potraživanja kao potencijalni sporovi, dok ustanovljavanje punovažnosti ovih potraživanja zahteva značajno vreme i profesionalnog rada.

Na osnovu člana 15 zakona za Kosovsku Agenciju za Privatizaciju, Odbor Direktora ima nadležnost da na osnovu zakona u snazi, razmatra sve zahteve i/ili potraživanja specificne prirode koja se klasifikuju kao takva dok predstavljaju prepreku u procesu vlasničke transformacije.

Agencija ohrabruje razna lica (fizička i/ili pravna) da imaju pravo da pokrenu proces direktnih pregovora sa ovom Agencijom ako se prethodno ustanovi da se njihova potraživanja klasifikuju kao specifični slučajevi (pravna osnova potraživanja, vrsta, složenost pitanja, poreklo potraživanja i ostalo, na osnovu gorenavedene Uredbe) i osvrću se na imovine nekog društvenog preduzeća koja na osnovu zakona na snagu spada pod nadležnost ove Institucije.

U skladu sa zakonom na snagu, iniciranje administrativne procedure za gore navedena pitanja se vrši na osnovu službene dužnosti Agenciej na ime i za račun društvenog preduzeća i uz zahtev zainteresovanih strana, koje uz pomoć regionalnih kancelarija i/ili službene stranice agencije mogu uzeti formular zahteva za iniciranje procedure koji sadrži osnovne elemente zahteva kao i neka osnovna uputstva.

Podrške radi, saveta i eventualnih razjašnjenja, građani imaju pravo da se obrate regionalnim kancelarijama i/ili glavnom sedištu Agencije, dok se popunjeni zahtev podnosi direktno u Regionalnoj kancelariji na cijoj teritorije se nalaze predmentna nekretnina.

Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës
Drejtoria Për Arsim dhe Edukim

*Nr: **11/214***
Më: 18.03.2019
Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212,(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS)Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASIIT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018. Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Drejtoria për Arsim dhe Edukim shpalë.

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të punës

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vendi i lirë/ zëvendësim	Numri i pozitave	orë
1	SHFMU"Kajtaz Ramadani" Kjevë	Arsimtar/e e mësimit klasor	Zëvendësim i lehonisë me kohë të caktuar	1	20

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal(letërnjoftimi ose pasaporta)
- Diplomat e kualifikimit(ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj.
- Certifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmitë e përvojës në institucionet arsimore (nëse ka)
- Çertifikata e lindjes

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor
Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kritereve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar.
Kriteret e kualifikimit: Për vendin e punës mësimdhënës të programit fillor kërkohen kualifikimet: **Fakulteti i Edukimit- Programi fillor; Fakulteti i Mësuesisë** ashtu siç planifikohet me UA të MASHT-it për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm Nr. 10/2018 të datës: 20.07.2018.

Vetëm në mungesë të kandidatëve nga sqarimi i lartcekur do të shqyrtohen edhe aplikacionet e kandidatëve me kualifikim më të përafërt.
III. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuar dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.
Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente(jo ata që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi)
Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara në MASHT.
Për intervistë do të ftohën ata kandidatë, të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të cekura.
Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në web- faqen e Komunës së Malishevës.
Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.
Afati dhe mënyra e aplikimit
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më**: 18.03.2019 më datën:01.04.2019**
Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit,përkatësisht përmes zyrës së pritjes së palëve, në objektin e ri të Komunës së Malishevës.

Njoftimi për shprehje të interesit

Emri i shkollës: **"Lidhja e Prizrenit"-** Opterushë
Komuna: **Rahovec**
Data: **19.03.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/096 - ESIP/SDG/096-CS/1.2	**Vizita kulturore me karakter edukativo-arsimor për mësimdhënës-nxënës dhe prindër**

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles:**Shfmu "Lidhja e Prizrenit"**-Opterushë - Rahovec. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
   - **Vizita kulturore me karakter edukativo-arsimor për mësimdhënës-nxënës dhe prindër**

2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
   - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
   - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën:**Shfmu "Lidhja e Prizrenit" Opterushë ,Rahovec**, më së largu deri më **27.03. 2019.**

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e shprehjes së interesit.
Detajet kontaktuese të shkollës:

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Skender Krasniqi
Telefoni: 044/366-516-E-maili: skrasniqi@live.com
Xhavit Bytyqi
Telefoni: 044/141-731 E-maili:xhavi.tbytyqi@hotmail.com

C.nr. 471/18

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEGA SUHAREKË si gjykata civile e shkallës së parë, në përbërje nga Gjyqtari Shaban Zeqiraj, në çështjen juridike të paditësit Ingrit Shefket Kuqi nga Suhareka , të cilin i përfaqëson Av.Besnik Kuqi nga Suhareka kundër të paditurit Haxhi dhe Agim Latif Kuqi nga K.Suhareka me padi për vërtetim pronësie në vlerë **4.500€** me kërkesë të paditësit është kërkuar që të caktohet përfaqësues të përkohshëm për të paditurin , andaj gjykata me dt.13.03.2019, merr këtë:

A K T V E N D I M

CAKTOHET: Av.Shaqir Sedolli nga Suhareka si përfaqësues i përkoshëm për palën e paditur Haxhi dhe Agim Latif Kuqi nga Suhareka , sipas padisë së paditësit Ingrit Shefket Kuqi , të cilin i përfaqëson Av.Besnik Kuqi, në çështjen juridiko-civile padi për vërtetim pronësie në vlerë **4.500€** me nr. të lëndës **C.nr.417/18**

Përfaqësuesi i përkohshëm do ta përfaqësoi të paditurin në procedurën kontestimore, në tërsi deri sa i padituri të paraqitet në gjykatë .

Shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm I bart pala paditëse .

A R S Y E T I M

Paditësi përmes të autorizuarit te vet Av.Besnik Kuqi, kësaj Gjykate i ka parshtruar padi kundër të paduturëve Haxhi dhe Agim Latif Kuqi nga Suhareka për çështjen juridiko-civile vërtetim pronësie në vlerë **4.500€** me nr. të lëndës **C.nr.471/18**

Gjykata me dt.13.03.2019, ne seancen përgaditore para se me u lëshuar në këtë seance,nga i autorizuri i paditësit Gjykata ka pranuar propozimin që të caktohet perfaqësuesi i përkohshëm, për arsye se ka kaluar një kohë relativisht e gjatë që nga paraqitje e kërkesës pranë gjykatës, andaj gjykata duke vepruar ne kuptim te nenit 79 alinea 3 pika (a) te LPK-së ka caktuar perfaqësues të përkohshem për të paditurin.

Gjykata për përfaqësues të përkohshem të palës së paditur ka caktuar Av. Shaqir Sedolli nga Suhareka me propozim të **OAK** që në pajtim me dispozitat e LPKsë ta përfaqësoi palen e paditur.

Me sa u cek me lart u vendos si ne dispozitivë të këtij aktvendimi në bazë të nenit 79 al 3 pika (a) të LPK-së .

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEGA SUHAREKË
C.nr.471/17 dt.13.03.19

Sek. Juridike
Ylkije Kryeziu
